



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
NJËSIA PËR SIGURIMIN E BRENDSHËM TË CILËSISË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

GRUPI I NJSBC

- | | | |
|------------------------|---|--|
| 1. Dr. Eris Rusi | Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë |  |
| 2. Msc. Riollza Agolli | Departamenti i Edukimit |  |
| 3. Dr. Alba Kreka | Departamenti i Histori- Gjeografisë |  |
| 4. Dr. Juliana Çyfeku | Departamenti i Gjuhëve të Huaja |  |
| 5. Bleona Orhan | Departamenti i i Gjuhës dhe i Letërsisë | Studente |

VITI AKADEMIK 2021-2022

PARATHËNIE PËR PROCESIN E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

PARIMET E PUNËS SË NJSBC

- Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paaanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL realizojnë vlerësimin e brendshëm me synimin që të krijohet një pamje e qartë dhe transparente e njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të IAL-së dhe të programeve të studimit.
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në IAL si pjesë e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumente, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.

PJESA PËRSHKRIMORE DHE ELEMENTËT SHPJEGUES

FEF u hap në bazë të Urdhrit nr. 16, datë 17.1.2012 të ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës dhe në nenin 41 të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, pasi u bë riorganizimi i ish- Fakultetit të Mësuesisë, i themeluar në vitin 1992, me vendimin nr. 5, datë 7 janar 1992 të Këshillit të Ministrave.

Nga viti 1992 e në vazhdim në këtë Fakultet janë hapur këto programe studimi të ciklit të parë “Bachelor”: Gjuhë Angleze (1994); Mësuesi për Arsimin Parashkollor (1995); Gjuhë-Letërsi (2005); Gjuhë-Letërsi Shqipe dhe Frënge (2009); Histori-Gjeografi (2010); Cikël i Ulët dhe Anglisht për Ciklin Fillor (2010, Filiali Pogradec); Mësuesi për Arsimin Fillor Kl. I-VI (2013).

Programet e studimit “Bachelor”: Mësuesi për Arsimin Parashkollor; Mësuesi për Arsimin Fillor Kl. I-VI; Gjuhë-Letërsi; Histori-Gjeografi, janë zhvilluar edhe në sistemin me kohë të pjesshme.

Në vitin akademik 2008-2009, hapen për herë të parë programet e studimit të ciklit të dytë “Master i Nivelit të Parë” (MNP) për: Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë dhe Arsimin e Mesëm në profilet “Gjuhë-Letërsi” dhe “Gjuhë Angleze”, me 60 kredite, të cilat në vitin akademik 2010-2011 u riorganizuan me 90 kredite, duke përfshirë profilet minore “Arte” dhe “Sporte”; “Master Profesional” në Mësimdhënie (2011) me 90 kredite për mësuesit specialistë të shkollave të mesme profesionale; “Master Profesional” Mësuesi për Ciklin e Ulët (2012) (sistemi me kohë të pjesshme); “Master i Shkencave” Arsimit Fillor kl. I-VI (2012); “Master Profesional”, Mësuesi Histori-gjeografi (2013).

Në stafin akademik të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë zhvillojnë veprimtarinë e tyre 44 pedagogë të brendshëm prej të cilëve: 3 me titull Profesor, 4 Profesorë të Asociuar, 28 Doktorë Shkencash, 1 Docent si dhe 7 Msc. (në proces doktore)

Në vitin akademik 2017-2018 u hap programi profesional dy-vjeçar "Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme". Si dhe u ristrukturua programet "Master" nga 90 kredite në 120 kredite.

Në vitin akademik 2018-2019, u hapën dy programe të reja studimi: "Master i Shkencave" në "Kulturë, Media dhe Editim" dhe një program profesional 2-vjeçar "Mbështetës Zyre për Komunikim, Bibliotekë dhe Arkiv".

Në vitin akademik 2019-2020 u hap programi Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”. Prej vitit 2012, funksionon Qendra e Ekselencës "FEF", e cila ka si qëllim zhvillimin e veprimtarive të trajnimit dhe të kualifikimit të mësuesve në shërbim. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë është akredituar për 42 module trajnimi. Nëpërmjet Qendrës së Ekselencës “FEF”, organizohet kualifikimi i mësuesve në shërbim, në gjashtë sesione treditore të përvitshme në gjithë rajonin e Korçës. Qendra e Ekselencës “FEF” ka një infrastrukturë të përshtatshme për trajnimin e mësuesve dhe një bibliotekë të specializuar për këtë qëllim, me 210 tituj dhe rreth 960 libra.

Pranë FEF është ngritur Qendra e "Gjuhës shqipe për të huaj", e cila funksionon bazuar në vendimin Nr. 12, datë 29.03.2013 të Senatit Akademik.

Që nga janari i vitit 2016, ekziston Qendra e Gjuhës Greke për dhënien e provimit dhe certifikimit ndërkombëtar të gjuhës greke.

FEF, si një prej 4 njësive kryesore të Universitetit “Fan S.Noli”, gëzon akreditim institucional për një periudhë 5-vjeçare, rezultat i vlerësimit të jashtëm, të kryer nga Quality

Assurance Agency (Britani e Madhe) dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë (Shqipëri).

SYNIMET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ka bërë si mision të vetin zhvillimin e një procesi mësimor e kërkimor sfidues, me infrastrukturë të mirë, e cila përfshin bibliotekën (me fonde librash që shtohen herë pas here), laboratorë të ndryshëm (në përputhje me kërkesat e programeve të studimit) si dhe teknologji bashkëkohore. Misioni i Fakultetit është të sigurojë një arsimim cilësor për studentët dhe të ofrojë përgatitje profesionale në edukim, por njëkohësisht të arrihen standardet e kërkuara në tregun e punës duke ofruar programe studimit që formojnë specialistë dhe mësimdhënës në drejtime të ndryshme (në varësi të programeve të studimit) Studentët përgatiten dhe diplomohen për një spektër të gjerë njohurish, e cila i ndihmon në zhvillimin e karrierës së ardhme dhe mbi të gjitha përgatiten si individë ndikues dhe kontribues në shoqëri përmes dijeve dhe shërbimit. Nw mwnyrw tw pwrmbledhur mund tw themi se:

Misioni i FEF është kthimi i tij në një qendër të dijes dhe të kërkimit. FEF ka si mision ndërmarrjen e iniciativave arsimore, kërkimore shkencore, intelektuale dhe kulturore dhe aplikimin e këtyre iniciativave, në fushat që përputhen me strukturën e Fakultetit.

Misioni i FEF është të sigurojë një arsimim cilësor për studentët duke ofruar programe studimi, që formojnë specialistë dhe mësimdhënës në fusha të ndryshme, t'i përgatisë ata profesionalisht duke krijuar kushtet e përshtatshme për dijet dhe praktikat profesionale.

Misioni i FEF është përshtatja e programeve të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës, si dhe orientimi i studentëve drejt tregut të punës që në kohën e studimeve universitare.

Mision të punës së tij FEF ka integrimin real të mësimdhënies me kërkimin shkencor, duke përfshirë studentët në projekte kërkimore të përbashkëta me pedagogun e të drejtuar prej tij, duke e konsideruar këtë si domosdoshmëri për të përballuar sfidat e shkollimit universitar,

FEF ka si mision formimin qytetar të studentëve si një mënyrë për edukimin e brezave të ardhëm në funksion të shtetit dhe shoqërisë.

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë ofron një numër të madh programesh studimi:

Programe studimi me karakter profesional:

- Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme;
- Mbështetës Zyre për Komunikim, Bibliotekë dhe Arkiv;
-

Programe të ciklit të parë Bachelor:

- Mësuesi për arsimin parashkollor;
- Mësuesi për arsimin fillor;
- Gjuhë angleze;
- Gjuhë dhe kulturë frënge;
- Gjuhë –Letërsi;
- Histori –Gjeografi;
-

Programe studimi të ciklit të dytë Master Profesional:

- Mësuesi për Arsimin Fillor,
- Mësuesi për Gjuhë-Letërsi,
- Mësuesi për Gjuhë Angleze,
- Mësuesi për Histori-Gjeografi,
-

Programe studimi të ciklit të dytë Master i Shkencave

- Kulturë, Media dhe Editim

Objektivi kryesor i programeve të studimit është t’u japë studentëve njohuritë e nevojshme dhe bazë për formimin e tyre profesional, si dhe për vazhdimin e studimeve të mëtejshme në fushat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Sipas specifikave përkatëse, objektivat që synojnë të arrijnë këto programe studimi dhe realizimi i tyre parqitet si më poshtë:

✓ **Diploma profesionale “Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme”**

mundëson hapin e parë drejt profesionit të edukatorit për grupmoshat 0-3 vjeç, për të punuar si në çerdhet shtetërore, ashtu edhe në ato private, si dhe në të gjitha strukturat që ofrojnë shërbime për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme, duke iu përgjigjur sa më mirë tregut të punës.

Ky program studimi do t’u ofrojë kompetenca profesionale individëve që mendojnë të punojnë si edukatorë në institucionet për këtë moshë, siç janë çerdhet, strukturat e ndryshme që ofrojnë shërbime për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme, shërbime në mbështetje të prindërve (qendrat për familjet apo kënde lojërash etj.).

Për të arritur këto kompetenca profesionale kursi artikulon ofertën formuese në kompetenca teorikë thelbësore (të natyrës pedagogjike, psiko-sociale, antropologjike), për të kuptuarit e kushteve të foshnjërisë dhe të fëmijërisë së hershme në shoqërinë bashkëkohore dhe modelet kryesore të ndërhyrjes pedagogjike dhe didaktike ekzistuese, si dhe të kompetencave praktike funksionale për zhvillimin e proceseve edukuese në kontekstet e përmendura.

✓ **Diploma profesionale “Mbështetës zyre për komunikim, bibliotekë dhe arkiv”**

synon t’u ofrojë kompetenca profesionale individëve që mendojnë të punojnë si punonjës mbështetës zyre në institucionet publike dhe jopublike, siç janë bibliotekat për të rritur dhe fëmijë, arkivat në nivel qendror apo institucione, si dhe struktura të ndryshme që ofrojnë shërbime për publikun. Ky program studimi u jep mundësi studentëve të punësohen si nëpunës mbështetës, për të punuar në zyrë, biblioteka dhe arkiva, dhe/apo institucione të tjera të ngjashme, si në sektorin publik ashtu edhe në atë jopublik, si dhe në të gjitha strukturat që ofrojnë shërbime të ngjashme. Me përfundimin e këtij programi studentët:

- Komunikojnë me profesionalizëm me publikun lidhur me dhënien, marrjen, transmetimin e informacioneve të ndryshme në institucion.
- Kryejnë detyra të sekretarië.
- Përgatisin, modifikojnë, redaktojnë, kopjojnë informacione gojore ose të shkruara dhe

dokumente e korrespondenca për ruajtje, përpunim, publikim apo transmetim, si dhe kryejnë regjistrime, kodifikime, veprime mirëmbajtjeje, shërbime ndaj klientëve, shkrime apo përpunim të dhënash duke përdorur pajisjet dhe programet e duhura për shkrimin e tekstit ose hedhjen e të dhënave të ndryshme sipas urdhrave përkatës.

-U shërbejnë klientëve të bibliotekës, të librarisë, në lidhje me kërkesat apo nevojat e tyre.

-Mirëmbajnë libra dhe dokumente të tjera të bibliotekave sipas procedurave dhe teknikave të nevojshme.

- Klasifikojnë dhe arkivojnë dokumentet sipas procedurave të caktuara në njësinë e vet të shërbimit.

Kompetencat formuese të programeve profesionale dyvjeçare janë bazuar mbi Listën Kombëtare të Profesioneve, miratuar me VKM nr. 514, dt. 20.9.2017.

Programet e Ciklit të Parë Bachelor

✓ **Programi “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”** mundëson arsim dhe edukim për të gjithë ata studentë që janë të interesuar të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale në mësuesi në ciklin parashkollor, si dhe ndjehen të motivuar të thellojnë më tej karrierën e tyre si kërkues dhe kontribues shkencorë në fushën e pedagogjisë. Ky program synon të përgatisë mësues për arsimin parashkollor me një formim të lartë teoriko-praktik, të aftë për t'iu përgjigjur me sukses proceseve reformuese në sistemin arsimor parashkollor dhe kërkesave në rritje të tregut të punës.

Studenti që mbaron arsimin parashkollor mund të punojë:

- mësuese në të gjitha institucionet parashkollore publike dhe private
- kujdestare fëmijësh në familje
- kujdestare fëmijësh në institucione të tjera të kujdesit për fëmijë.

Gjithashtu, studentit i jepet mundësia të vijojë studimet e ciklit të dytë në arsim fillor apo dhe në një nga degët e tjera të pedagogjisë.

Studenti pajiset me kompetencat e duhura për arritjen e standardeve të larta në mësimdhënie në arsimin parashkollor, me shprehje afatgjata për zgjidhjen e situatave problemore, për menaxhimin e mjedisit njohës, social, emocional dhe fizik të klasës, si dhe me njohuri plotësuese në lidhje me karakteristikat e grupmoshave, arsimin gjithëpërfshirës dhe fëmijët me nevoja të veçanta, përparësitë e arsimit në Shqipëri dhe rolin e mësuesit si profesionist në një kontekst social që ndryshon.

✓ **Programi “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Fillor”** synon të përgatisë profesionistë të nivelit të parë për tregun e punës brenda dhe jashtë vendit me shprehje të veçanta që mundësojnë një rol të shumëfishtë të mësuesit. Programi paraqitet si një ofertë akademike elastike duke mbajtur parasysh përvojën aktive dhe interesat e studentëve për një ekonomi më të zhvilluar dhe shoqëri më të drejtë.

Mundësitë për punësim

Diploma “Bachelor” e lëshuar prej Universitetit “ Fan S. Noli ” në Korçë, përveç aksesit për të vazhduar studimet e nivelit të dytë, “Master”, mundëson hapin e parë drejt profesionit të mësuesit në institucionet arsimore publike dhe private.

✓ Programi i studimit **“Bachelor” në “Gjuhë-Letërsi”** synon të japë njohuritë bazë për gjuhën shqipe dhe shkencën e gjuhësisë, si dhe për historinë e letërsisë (shqiptare dhe botërore) dhe shkencën për letërsinë. Diploma “Bachelor” mundëson hapin e parë drejt profesionit të mësuesit për klasat VI-IX, që do të punojë në këto klasa, si në shkollat shtetërore ashtu edhe në ato private, duke ju përgjigjur sa më mirë tregut të punës. Gjithashtu, ajo mundëson vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë, Master. Kjo diplomë mundëson punësim të studentëve në tregun e punës që lidhet me administratën publike, si në marrëdhënie ndërkombëtare, në fushën e turizmit, tregtisë, etj. Gjithashtu, programi do të

shërbejë për të ndihmuar studentët që njohuritë e tyre t'i zbatojnë në disiplina të tjera, si: gazetari, redaktori dhe punonjës i trashëgimisë kulturore.

Në përfundim të këtij programi studenti pajiset me kompetencat e perceptimit, analizës, përvetësimit të kategorive gjuhësore dhe letrare. Studenti:

kupton dhe përkufizon konceptet themelore gjuhësore e letrare;

analizon kontekstet e përdorimit të kategorive gjuhësore e letrare dhe të vlerësojë se sa dhe si i shërbejnë ato ligjërit të tij;

është i përgatitur në përvetësimin e njohurive më të thelluara teorike dhe praktike në specialitetin e mësuesisë, gjuhëtarit, gazetarit a kritikut letrar.

✓ **Programi i studimit “Bachelor” në “Gjuhë Angleze”** synon:

Të pajisë studentët me njohuritë bazë për gjuhën angleze, kulturën angleze dhe amerikane, si dhe me njohuri për shkencën e gjuhësisë, për historinë e letërsisë, koncepte që lidhen me studimin e letërsisë dhe të kulturës, veçanërisht asaj angleze dhe amerikane.

Programi synon të përgatisë një gjeneratë të re të ekspertëve të gjuhës në fushën e gjuhës angleze, të zhvillojë dialogun ndërkulturor, të rrisë mundësitë e të rinjve për të studiuar dhe punuar jashtë vendit, të lehtësojë mundësitë e punësimit në organizata dhe kultura zyre ku anglishtja është mjeti kryesor i komunikimit. Profili akademik i programit është i dyfishtë. Kompetenca gjuhësore në anglishte zhvillohet me anë të Profilit të Përgjithshëm të Gjuhës Angleze, ndërsa studentët fitojnë edhe shkathësi të përkthimit.

Studenti që mbaron këtë program studimi mund të punojë përkthyes me një nivel të pëlqyeshëm formimi në administratën shtetërore, kompani të ndryshme dhe organizma të ndryshëm të shoqërisë civile.

Nëpërmjet këtyre studimeve hidhet hapi i parë drejt përgatitjes si mësues i gjuhës angleze në arsimin fillor, në atë të mesëm të ulët dhe të lartë, si dhe jep mundësi për të vazhduar studimet e Ciklit të Dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”.

✓ **Programi i studimit “Bachelor” në “Gjuhë dhe Kulturë Frënge”** synon të pajisë

studentët me njohuritë bazë për gjuhën dhe kulturën frënge, si dhe me njohuri për shkencën e gjuhësisë, për historinë e letërsisë, koncepte që lidhen me studimin e letërsisë dhe të kulturës, veçanërisht asaj frënge, si dhe me njohuri plotësuese për ato fusha që ndihmojnë dhe japin mundësi zhvillimi të mëtejshme, në drejtime të tjera studimi, ngushtësisht të lidhura me natyrën e gjuhës dhe kultures frënge.

Diploma “Bachelor” e lëshuar prej Universitetit “Fan S. Noli” në Korçë, përveç aksesit për të vazhduar studimet e nivelit të dytë, “Master”, mundëson hapin e parë drejt profesionit të mësuesit. Gjithashtu studenti mund të punojë:

përkthyes i teksteve pragmatike pranë mediave të ndryshme

interpret konferencash

përkthyes pranë shtëpive botuese

përkthyes apo interpret pranë agjencive të përkthimit

Kompetenca ndërkulturore, kompetenca komunikuese, me gjithë interpretimet e ndryshme që i bëhen asaj, kompetenca individuale, sociale, strategjike, profesionale, të cilat gjejnë zgjerim në kontekstin ndërkulturor, e pajisin studentin me shprehje afatgjata për jetën.

✓ **Programi i studimit “Bachelor” në “Histori - Gjeografi”** synon:

Të japë njohuritë bazë për historinë, gjeografinë dhe studimin e tyre, në kontekstin kombëtar dhe atë botëror;

Të japë njohuri plotësuese për ato fusha që ndihmojnë dhe japin mundësi zhvillimi të mëtejshme në drejtime të tjera studimi ngushtësisht të lidhura me historinë dhe gjeografinë;

Të aftësojë studentin me njohuritë bazë në shkencën e historisë së Shqipërisë dhe atë botërore;

Të aftësojë studentin me njohuritë bazë në shkencën e gjeografisë së Shqipërisë dhe në kontekst më të gjerë;

Të përgatisë studentë për të ndjekur programet e studimit për mësues të ardhshëm të historisë dhe gjeografisë.

Diploma “Bachelor” mundëson hapin e parë drejt profesionit të mësuesit si në shkollat shtetërore, ashtu edhe në ato private duke ju përgjigjur sa më mirë tregut të punës. Kjo diplomë mundëson punësim të studentëve në tregun e punës që lidhet me administratën publike, si në marrëdhënie ndërkombëtare, në fushën e turizmit, tregtisë, etj. Gjithashtu, ajo mundëson vazhdimin e studimeve në nivelin e dytë, Master.

Studenti fiton kompetencat e një të arsyetuarit analitik në drejtim të memories historike dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

✓ Programet e studimit “**Master Profesional**” në “**Mësuesi**” në fushat e: Arsimit Fillor, Histori-Gjeografisë, Gjuhë-Letërsisë dhe Gjuhës Angleze, synojnë :

T’u japin mundësi kandidatëve që të përfitojnë kompetencat e nevojshme për të ushtruar me sukses profesionin e mësuesit në një kontekst social-kulturor në ndryshim.

Një nivel të ri të cilësisë së përgatitjes fillestare të mësuesve në fushat e sipërpërmendura.

Përmbajtje të gjerë të dijeve në shkencën e edukimit dhe në didaktikë, për nga sasia e konsiderueshme e praktikimit në mësimdhënie, me një fokus të qartë në kërkim dhe një qasje interesante në çështje të tilla si testimi, menaxhimi, strategjitë e të nxënës, punë kërkimore dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Të aftësojë studentët që të zotërojnë njohuri të plota të përmbajtjes dhe kurrikulës lëndore, për të siguruar një mësimdhënie të efektshme në fushën përkatëse.

Të formojnë profesionistë, zotërues të metodave të kërkimit ndërdisiplinor që takojnë në të njëjtën kohë si përmbajtjen lëndore ashtu edhe atë pedagogjike.

Mbajtësit e këtyre diplomave kanë mundësi për t’u punësuar në shkollat publike dhe private të arsimit parauniversitar, si dhe në sektorët e tjerë të veprimtarisë edukative dhe shoqërore.

✓ Programi i studimit “**Master i Shkencave**” në “**Kulturë, Media dhe Editim**” synon t’u ofrojë studentëve kompetenca profesionale dhe thellim të njohurive shkencore dhe profesionale në fushën e kulturës, medias dhe editimit përmes disiplinave të ndryshme që ofrohen me synim formimin e specialistëve të mirëfilltë në fushat përkatëse që mbulon ky program studimi, si dhe krijimin e mundësive për vazhdimin e studimeve në nivelin e tretë të studimeve “Master ekzekutiv” apo “Doktoratë”.

Gjatë viteve të studimit në këtë program studimi, përmes lëndëve që zhvillohen, synohet që studentët të pajisen me:

Njohuri të thelluara në kontekstin historik, institucional dhe social të kulturës dhe medias, si dhe të praktikave të kërkimit në këto fusha.

Njohuri të thelluara të teknologjive dhe përvojave të bazuara në kontekstin e dizajnit në kulturë dhe media.

Njohuri të thelluara në fushën e botimeve dhe praktikave lidhur me përgatitjen e materialeve për botim.

Ky program studimi mundëson formimin e plotë të specialistit në fushën e kulturës dhe medias për të punuar në sektorin publik dhe në atë jopublik, si dhe në të gjitha strukturat që ofrojnë shërbime të ngjashme, duke iu përgjigjur sa më mirë tregut të punës.

Falë njohurive të fituara nga lëndët e zhvilluara në këtë program si dhe aftësive për t’i zbatuar ato në praktikë synohet që studentët të zotërojnë:

Kompetencat e zbatimit në praktikë të njohurive të nevojshme për të zhvilluar strategji të përhapjes dhe promovimit në sektorin e kulturës dhe medias në kuadër të zhvillimit të

turizmit të vendit mbështetur në vlerat kombëtare;

Kompetenca të thelluara në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve në fushën e kulturës dhe medias me synim promovimin e vlerave kulturore lokale, kombëtare dhe globale.

Kompetenca në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme në fushën e kulturës kombëtare dhe vlerave të saj në kushtet e globalizimit.

HYRJE

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve profesionale, referuar Nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikime, programeve të ciklit të parë të studimit “Bachelor” dhe programeve të ciklit të dytë “Master” në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti “Fan S. Noli” në Korçë, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm.

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim korrekt, të bazuar në tregues realë dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, të përgatisë një raport i cili do të shërbejë si bazë për grupin e vlerësimit të jashtëm, gjatë procesit të akreditimit.

Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, GVB është bërë pjesë e trajnimeve paraprake të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Universitetit, mbi bazën e përvojës së vlerësimeve të mëparshme, duke hartuar edhe një plan pune, duke ndarë detyrat dhe duke udhëzuar GVB për përmbushjen e detyrave.

Për hartimin e këtij raporti, GVB ka mbajtur parasysh raportin e viteve të kaluara, si dhe raportin e GVJ që është realizuar në kuadër të akreditimit institucional.

Gjithashtu u shfytëzuan të gjitha materialet, të dhënat e Fakultetit, vlerësimet e kryera nga studentët për procesin mësimor, për stafin akademik, për infrastrukturën. Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë:

- Ligj nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve
- Raporti i Vlerësimit Institucional i Universitetit "Fan S. Noli" Korçë viti akademik 2019-2020
- Analiza e punës mësimore–shkencore 2020-2021 për Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë
- Udhëzimet e MASR-së
- Dokumente të veprimtarisë institucionale të Universitetit “Fan S. Noli”, më konkretisht:
 - Statuti i UK-së,
 - Rregullore e UK-së,
 - Rregulloren e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë
 - Rregulloret e Programeve të studimit
 - Rregullore e transferimeve - Rregullore ESSE3
 - Planet mësimore - Formularët e ngarkesës vjetore të stafit

SKEDA INFORMATIVE

Fakulteti	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	
Adresa:	Shëtitorja “Rilindasit” Korçë	
Email:	dekanati@yahoo.com	
Licencuar:	Vendimi nr. 5, datë 7 janar 1992. Licencuar si Fakulteti i Pedagogjisë	
Statusi aktual ligjor:	Urdhër nr. 16, datë 17.1.2012. Emërtuar: “Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë	
Përfaqësuesi zyrtar:	Prof.as.dr. Jonela Spaho Tel. : ++ 355 822 48944 e-mail: jspaho@unkorce.edu.al e-mail: jspaho@gmail.com	Dekan i Fakultetit
	Dr. Orion Ago Tel. : 0696442144 e-mail: oago@unkorce.edu.al	Zv.Dekan i Fakultetit
Struktura Akademike:	Departamenti i Edukimit Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Departamenti i Gjuhëve të Huaja Departamenti i Histori-Gjeografisë	
Oferta Akademike:	Program profesional 2-vjeçar pas arsimit të mesëm (Niveli 5 KSHK) Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor) (Niveli 6 KSHK) Cikli i Dytë i Studimeve (Master i Shkencave, Master Profesional) (Niveli 7 KSHK)	

OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E NJSBC

Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.

Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL.

Të realizojë Vlerësimin e Brendshëm me synimin që të krijohet një tablo e qartë dhe transparente e Njesisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të institucioneve e programeve

Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.

Të shërbejë në fund të fundit për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë si pjesë e tyre e brendshme dhe e qëndrueshme.

Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumente, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.

Shënim:

Pjesa më poshtë sipas standarteve do të jepet në formë analitike, përmbushja ose jo e Standardit do të jepet duke bërë edhe analizat përkatëse se deri në çfarë niveli përmbushet Standardi, ku ka vend për përmirësim, veprimet që duhet të ndërmeren për të ndryshuar ose përmirësuar etj., dokumentet mbështetëse për sa më sipër do të vihen të gjitha në pjesën II (Tregues të Matshëm), dhe numri i tabelës dhe faqes ku mund të gjendet në këtë dokument, do të përfshihen në këtë pjesë.

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1

Njësia e institucionit të arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

UNIKO në gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Këtë mision ai e realizon përmes këtyre synimeve:

- të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fushat që mbulon në të gjitha programet e studimit, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikave profesionale, duke përmbushur të gjitha detyrat që rrjedhin nga nënshkrimi i Deklaratës së Bolonjës.
- të formojë shkencëtarë të rinj në fusha të ndryshme parësore, duke marrë parasysh drejtimet kryesore të zhvillimit të rajonit, nëpërmjet kërkimit shkencor dhe veprimtarisë botuese .
- si promotor i formës më të lartë të arsimit, ai synon edhe përvetësimin e kompetencave specifike dhe saktësinë metodologjike për ta bërë individin jo vetëm specialist kompetent, por dhe një qytetar të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë.
- të kryejë studime shkencore për të zhvilluar programet e studimit të shkencave që lëvron dhe të ofrojë shërbime për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme që ka rajoni i Korçës dhe më gjerë;
- të kryejë kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të lartë të fushave të ndryshme, duke u kthyer në një qendër e rëndësishme kualifikimi dhe zhvillimi të teknologjive bashkëkohore.
- t'u sigurojë punonjësve akademikë pavarësinë e kërkimit dhe lirinë e mësimdhënies, sipas dispozitave të këtij statuti dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Zhvillimi ekonomik dhe social i vendit kërkon përgatitjen e profesionistëve të aftë që përmbushin kërkesat e tregut të punës në vend, por dhe në atë ndërkombëtar, njëkohësisht të ruajnë, të promovojnë dhe të zhvillojnë vlerat e kulturës kombëtare. Në rregulloret e programeve të studimit për secilin program përcaktohet qartë qëllimi dhe misioni i programit të studimit. Programet e studimit që ofrohen në FEF, janë hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e UNIKO dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në vite akademike, për të reflektuar prioritetet strategjike të insitucionit dhe interesat e zhvillimit të vendit¹².

Gjithashtu përcaktohen edhe objektivat³, si dhe elementet që lidhen me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit^{4 5}ku studentët përftojnë dijet e nevojshme, rritin aftësitë individuale dhe kom Programet e

¹ Anex I. Dok. 1.1.Statuti UNIKO, Neni 1-2; Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020, (Misioni, fq.9)

² Anex I. Dok. 1.2.Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020, (Misioni, fq.9)

³ Anex I. Dok. 1.3. Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve;

⁴ Anex I. Dok. 1.4. Shembull praktike e studimit të tregut të punës programi 2-vjeçar me karakter profesional.

studimit në FEF, ofrojnë një paketë akademike që lidhet ngushtë me interesat kombëtare të vendit, duke përgatitur profesionistë të mirëfilltë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në ruajtjen, konsolidimin, studimin dhe promovimin e interesave kombëtare përmes përfshirjes në programet përkatëse të studimeve.

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të njësisë të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Programet e studimit që ofrohen në FEF, përputhen më së miri me fushat strategjike të strategjisë së zhvillimit të institucionit⁶. Fushat e studimit për këto programe, përkojnë me drejtimit e kërkimit shkencor në UNIKO⁷. Referuar Ligjit, Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe Statutit të UK-së, misioni i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë shkon në të njëjtën linjë me misionin e universitetit për të ndërtuar në rajonin juglindor një qendër arsimore publike urbane. Misioni i Fakultetit është të sigurojë një arsimim cilësor për studentët dhe të ofrojë përgatitje profesionale në edukim, por njëkohësisht të arrihen standardet e kërkuara në tregun e punës duke ofruar programe studimi që formojnë specialistë dhe mësimdhënës në drejtime të ndryshme (në varësi të programeve të studimit). Studentët përgatiten dhe diplomohen për një spektër të gjerë njohurish, e cila i ndihmon në zhvillimin e karrierës së ardhme dhe mbi të gjitha përgatiten si individë ndikues dhe kontribuues në shoqëri përmes dijeve dhe shërbimit. Drejtimit strategjike identifikohen dhe shprehen nëpërmjet një sërë objektivash të ndërlidhura ku mes të tjerash synohet rritja e cilësisë së diplomave që jepen dhe rritja e cilësisë së kërkimit shkencor⁸. FEF synon gjithashtu që nëpërmjet kërkimit bazë dhe të aplikuar, të përmirësojë atë në fushat e sipërpërmenduar⁹.

Programet e studimit që ofrohen në FEF janë hartuar, emërtohen dhe zhvillohen sipas fushave prioritare të zhvillimit të UNIKO, në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit¹⁰. Para fillimit të vitit akademik, departamentet diskutojnë ndryshimet e mundshme në rregulloret e programeve të studimit, me qëllim përditësimin e tyre në përputhje me zhvillimet e reja, prirjet e regjistrimeve dhe sugjerimet e bëra nga studentët dhe stafi. Ndryshimet në plane mësimore, pas miratimit në dekanat¹¹ dhe në Senatin Akademik, reflektohen në faqen zyrtare të universitetit¹².

Programet e studimit në FEF hartohen nga Departamentet përkatëse, miratohen nga Senati Akademik i UNIKO,

⁵ Anex I. Dok. 1.5. VKM Nr. 514, datë 20.9.2017, "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar"

⁶ Anex I. Dok. 1.6. Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020, (Fusha strategjike: Edukimi. fq.21)

⁷ Dok. 1.7. <http://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor>

⁸ Anex I. Dok. 1.8. <http://www.unkorce.edu.al/sq/fakulteti-i-edukimit-dhe-filologjise>

⁹ Anex I. Dok. 1.9. Rregullore e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

¹⁰ Anex I. Dok. 1.10. Rregullore UNIKO, KREU VI; <http://www.unkorce.edu.al/sq/rregullore-e-organizimit-dhe-veprimtaris%C3%AB-m%C3%ABsimore-k%C3%ABrkimore-shkencore-e-universitetit-%E2%80%9Cfan-s-noli%E2%80%9D>

¹¹ Anex I. Dok. 1.11. Praktika e miratimit të ndryshimeve në planin mësimor

¹² Anex I. Dok. 1.12. <http://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit>

Kreu VI, Neni 47, pika 3, si dhe organizohen në përputhje me Rregulloren e Organizimit të Veprimtarisë Mësimore Kërkimore dhe Shkencore të UNIKO-së, Kreu VI, Neni 57, pika 3. UNIKO ka si mision "...të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit.... të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal....", të sanksionuar në Statutin e UNIKO, Kreu I, neni 2, i cili përputhet me drejtimit e synuara të shprehura në misionin e Departamenteve të FEF, duke mundësuar kurrikula në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, ku studentët fitojnë kompetenca profesionale për të marrë vendime dhe veprime në përshtatje me situatat reale konkurruese të tregut.

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi II.1

Standardi II.1 - Programet e studimit synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës

Programet e studimit që ofrohen në FEF si ofertë akademike, plotësojnë kërkesat e maturantëve për të vazhduar studimet në këto drejtim dhe vlerësimin të stafit drejtues për nevojën e plotësimit të ofertës së institucionit me programe në këto fusha studimi që çojnë kryesisht në profesionin e mësuesit sipas kriterëve të LPAL. UNIKO ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione aktorë dhe faktorë në zhvillimin e institucionit, me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit (shtojca - Marrëveshjet e UNIKO).

Gjithashtu FEF ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të administratës publike në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, organizata profesionale e sipërmarrje me të cilat bashkëpunohet në aplikimin praktik të njohurive, zhvillimin e praktikave profesionale, ofrimi i intershipëve, organizimin e veprimtarive të përbashkëta shkencore dhe promovuese, që ndihmojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor (shtojca - Marrëveshjet e FEF).

Nga ana tjetër, programi Pranë UNIKO funksionon Qendra e Formimit të Vazhduar, e cila mundëson trajnime profesionale me module specifike për mësuesit në detyrë, në profile të ndryshme, por njëkohësisht dhe për studentë që duan të aftësohen në fusha specifike që lidhen me profilin e tyre të studimit. Njëkohësisht kjo qendër shërben edhe si instrument matës për të ndjekur ecurinë e studentëve që diplomohen dhe përthithen nga tregu i punës, duke reflektuar edhe mbi cilësinë e programeve të studimit. (shtojca - Module orientuese, Qendra e Formimit të Vazhduar).

Programet me karakter profesional janë mbështetur në Listën Kombëtare të Profesioneve, me qëllim që t'i përshtaten nevojave të tregut të punës¹³, si dhe ndërmarrjes së marrëveshjeve të përbashkëta me institucionet e ndryshme në kuadër të studimit të tregut të punës, duke marrë parasysh mundësitë e punësimit, kërkesat e punëdhënësve etj.

Aktiviteti i FEF-it në kuadrin e UNIKO-s si institucion i arsimit të lartë mbështetet në një pamje të hapur të bashkëpunimit dhe partneritetit me institucionet arsimore dhe joarsimore, në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.¹⁴¹⁵

¹³ Anex II. Dok. 2.2. VKM Nr. 514, datë 20.9.2017, "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar": Kodi i profesionit: 44; Kodi i profesionit: 262; Kodi i profesionit: 531

¹⁴ Anex II. Dok. 2.5. <http://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor>. Bashkëpunime

¹⁵ Anex II. Dok. 2.6. <http://www.unkorce.edu.al/sq/content/u-zhvilluan-n%C3%AB-uniko-disa-takime-mbi-%C3%A7%C3%ABshtjet-e-didaktikave-dhe-praktikave-profesionale-p%C3%ABr>

Kurrikula aktuale e programeve të studimit është vazhdimisht e ristrukturuar me qëllim rritjen e vlerës së diplomës së dhënë në tregun e punës.¹⁶¹⁷

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi II.2

Standardi II.2 - Programet e studimit synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare

Programet që ofrohen në FEF, i plotësojnë kriteret e këtij standardi.¹⁸¹⁹

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi II.3 - Njësia, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre

UNIKO është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative. Për këtë, funksionon rrjeti i cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UNIKO, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë si dhe standardet dhe udhëzimet europiane për Sigurimin e Cilësisë në HEAL të përcaktuara në Statutin e UNIKO, Kreu IX, Neni 73.

Rrjeti i Cilësisë përbëhet nga Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni (SKVIA), i ngritur brenda DKVI. SKVIA ndjek sigurimin e cilësisë (proceset e ndërmarra për arritjen e standardeve) dhe kontrollin e cilësisë (me synim përmirësimin e vazhdueshëm të tij). Ky sektor bashkëpunon me njësitë bazë dhe ka mbështetjen e Dekanëve dhe përgjegjësve të departamenteve për programet e studimit që menaxhohen prej tyre, të përcaktuara në Rregulloren e DKVI, Kreu III, Neni 6. Brenda këtij sektori funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), me përfaqësues një koordinator nga çdo njësi bazë dhe nga organizimet studentore. NJSBC vlerëson periodikisht rezultatet në arritjen e cilësisë. Raportet e vlerësimit të NJSBC shërbejnë si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë- – Rregullore e DKVI, Kreu V, Neni 24. FEF përdor metodologji vlerësimi për tërë veprimtaritë me karakter kontrolli që organizohen nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë NJSBC në shkallë universiteti. Njëherazi, rekomandon detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë NJSBC. Institucioni merr feedback lidhur me cilësinë e programeve që ofron, edhe nga kontakti me ish- studentët e tij, Alumni, të cilët janë mësues në shërbim dhe

¹⁶ Anex II. Dok. 2.7. Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020, (Harta strategjike, A.1. – A.3; fq. 19)

¹⁷ Anex II. Dok. 2.8. Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve

¹⁸ Anex II. Dok. 2.9. Rregullore e Veprimtarisë FEF. Kreu VI, Programet e studimit dhe organizimi i tyre.

https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/RREGULLORE%20E%20ORGANIZIMIT%20DHE%20VEPRIMTARISE%20MESIMORE_0.pdf

¹⁹ Anex II. Dok. 2.10. Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve-Objektivat formuese.

zhvillojnë pranë Qendrës së Formimit të Vazhduar trajnime të përvitshme në sesione të ndryshme gjatë vitit në kuadër të zhvillimit profesional, sipas akteve ligjore në fuqi.

Për çdo vit akademik Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë harton kalendarin e veprimtarisë së sektorit të kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë i cili ndiqet nga NJSBC së fakultetit.²⁰

NJSBC kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me pyetësorë me të gjithë studentët, për lëndët dhe pedagogët. Rezultatet përpunohen në raporte periodike²¹.

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Për sigurimin e cilësisë në FEF, tregohet kujdes i veçantë. Ai, ashtu si në gjithë strukturat e UNIKO-së konsiderohet përparësi për secilin punonjës, ndiqet me kujdes nga strukturat drejtuese dhe monitorohet në mënyrë permanente nga NJSBC. Përvoja e derisotme dëshmon për nevojën e një kontrolli të tillë, për domosdoshmërinë e një njësie të posaçme monitorimi, që orienton institucionin drejt plotësimit të standardeve të cilësisë dhe shërben si forcë shtytëse për një performancë në rritje në nivel institucioni dhe për çdo individ.

Feedback –u i marrë nga kontakti me ish-studentët e tij, Alumni, të cilët janë mësues në shërbim dhe zhvillojnë pranë Qendrës së Formimit të Vazhduar trajnime të përvitshme në sesione të ndryshme gjatë vitit në kuadër të zhvillimit profesional, sipas akteve ligjore në fuqi, janë një element i rëndësishëm që mbahet parasysh lidhur me cilësinë e programeve që ofron fakulteti.

Standardi II.4 - Programet e studimit janë të detajuara dhe informuese

Programet që ofrohen në FEF janë programe të licensuara me VKM ose Urdhër të MASR-së dhe janë të organizuara në përputhje me udhëzimet e MASR-ja dhe lëndët e modulet vlerësohen me kredite ECTS. Ngarkesa vjetore është 60 kredite, e ndarë në mënyrë të balancuar mes dy semestrave. Programet ofrohen me kohë të plotë.

Programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të afishuara në këndet përkatëse të fakultetit, pranë departamenteve, në mjedise publike dhe gjithashtu gjenden edhe në faqen e internetit të UNIKO sipas fakulteteve përkatëse²². Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion programi i të gjitha lëndëve që do të zhvillohen, ku janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar, ngarkesa, temat për çdo javë mësimore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar. Kjo gjë është e parashikuar dhe në sylabuset e lëndëve. Gjithashtu edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni luan një rol të

²⁰ Anex VI. Dok. 6.6. <http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/2018-2019%20PLANI%20SKSC.pdf>

²¹ Anex VI. Dok. 6.7. <http://www.unkorce.edu.al/sq/fakulteti-i-edukimit-dhe-filologjise> Sigurimi i Cilësisë

²² Anex VII. Dok. 7.37. <https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit>

rëndësishëm në informimin e studentëve lidhur me detajimin dhe informimin e programeve të studimit.²³

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

III - PERSONELI I NJËSISË SË INSTITUCIONIT

Standardi III.1 - Njësia e institucionit ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit

Administrimi i bazës së të dhënave mbi personelin akademik, ndihmësmësimor, shkencor dhe administrativ, bëhet nga Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore në UNIKO, mbështetur në *Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit*, Neni 4, Pika c dhe Neni 5, Pika 3. Kjo bazë të dhënash, mes të tjerash, përfshin dokumentacionin përkatës mbi organikën e FEF, CV e personelit akademik dhe personelit ndihmësakademik dhe administrativ, të angazhuar në realizimin e programeve të studimit.

Veprimtaria rekrutuese e UNIKO karakterizohet nga transparenca ndaj publikut, paanshmëria, mundësi të barabarta të konkurimit dhe zbatim rigoroz i kriterëve ligjore të parashikuara në *Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015*, Neni 64, Pika (1) dhe *Kodit të Punës (i përditësuar)* (qbz.gov.al) Në zbatim të këtij ligji, në *Rregulloren e UNIKO*, Kreu V, Neni 32, parashikohen kriteret e përgjithshme. Kriteret specifike përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga rektori sipas përcaktimeve në *Statutin e UNIKO*, Kreu V, Neni 40.

Me publikimin e shpalljes së vendit vakant në *Buletin e Njoftimeve Publike* sipas përcaktimeve të VKM Nr.176, dt. 29.03.2006 "*Për botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike*" dhe në faqen web, kandidatëve potenciale u jepet mundësia të depozitojnë dokumentacionin përkatës brenda afatit të përcaktuar në njoftim.

Kriteret e punësimit sanksionojnë zhvillimin e një konkursi publik, të hapur dhe të paanshëm. Në *Statutin e UNIKO*, Kreu V, Neni 40, përcaktohet procedura e rekrutimit, e zhvillimit të konkursit, si dhe e ngritjes së komisionit *ad hoc*. Kompetenca themelore e këtij komisioni të posaçëm është shqyrtimi i pajtueshmërisë së dokumentacionit të depozituar nga ana e kandidatëve, me kriteret e përgjithshme të përcaktuara në ligj dhe rregullore dhe kriteret specifike të përcaktuara nga njësia bazë.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve, që punësohen si personel akademik, realizohet sipas *Udhëzimit të Rektorit të UNIKO*, Nr. 594, dt. 08.10.2018 i përditësuar "*Për vlerësimin e kandidatëve që punësohen si personel akademik*".

Për të diferencuar cilësinë e personelit, epërsi i jepet kriterit të specialitetit të diplomës universitare dhe notës mesatare, i cili është edhe kriter skualifikues.

Në Pikën (5) të këtij Udhëzimi, parashikohet se në rast se, në fund të procesit të vlerësimit do të rezultojnë kandidatë me pikë të barabarta, atëherë përparësi do t'i jepet kandidatit që zotëron diploma të fituara në universitete të njohura të vendeve të OECD. Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, nënshkruhet Kontrata

²³ Anex VII. Dok. 7.39. <https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/udherefyesi2020.pdf>

individuale e punës ndërmjet tij dhe Rektorit si autoriteti përfaqësues i UNIKO. Pas nxjerrjes së urdhërit të emërimit prej Rektorit, kandidati fitues ushtron kompetencat e marra përsipër në kontratën individuale të punës.

Përsa i përket rekrutimit të pedagogëve me kohë të pjesshme, procedura paraprihet nga një mbledhje e zhvilluar në nivel departamentesh. Departamenti diskuton shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe propozon kriteret specifike që kanë në bazë specialitetin, kualifikimin, por sidomos përputhjen midis specialitetit dhe disiplinës që do të japë mësim.

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi III.2 - Njësia e institucionit disponon një bazë të dhënash për personelin e tij

Departamentet për programet dhe lëndët që menaxhojnë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mbajnë të dhëna të plota dhe të hollësishme në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie, formën e punësimit, ngarkesën që mbulon. Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik; të cilat i ka të parashikuara në dokumente që rregullojnë veprimtarinë e tij.

Të gjithë departamentet kanë angazhuar si titullarë të lëndëve/moduleve për Programet e studimit të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku titullin Prof. /Prof.as.dr.

Dosjet e personelit akademik të brendshëm dhe administrativ kanë në përbërje dokumentacionin e mëposhtëm: Dokumentin e identitetit (fotokopje e pasaportës ose kartës së identitetit)

Dokumentin që vërteton punën e kryer më parë (librezë pune ose vërtetim nga punëdhënësi i mëparshëm)

Librezën e sigurimit shoqëror e shëndetësor Diplomën e shkollës së lartë dhe listën e notave

Kualifikimet e tjera profesionale (brenda ose jashtë vendit) Gradat shkencore apo titujt akademikë

Raportin mjekësor për aftësimin në punë ose librezën shëndetësore, lëshuar nga inspektoriat sanitari shtetëror i vendbanimit ose ndonjë dokument tjetër të nevojshëm, sipas specifikës së vendit të punës.

E gjithë procedura pasqyrohet në statutin e UNIKO. (Të gjitha këto të dhëna gjenden tek Zyra e Burimeve Njerëzore të Universitetit).

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi III.3 - Njësia e institucionit angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij

Në strukturën organizative janë përfshirë staf ndihmës mësimor dhe IT lidhur me angazhimin maksimal në funksion të ecurisë së punës dhe përmbushjes së objektivave. Kjo është parashi-kuar si në organogramën e fakultetit, ashtu edhe në rregulloren e studimeve. Stafi i Zyrës së IT-së, i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës, dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, është i kualifikuar dhe në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimi.

Gjithashtu personeli administrativ është gjithmonë në shërbim të studentëve dhe personelit akademik për të siguruar mbarë-vajtjen e procesit akademik. Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave

profesionale FEF ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike për të garantuar zhvillimin e praktikave në institucionet përkatëse sipas profilit.

Përveç praktikave në institucione, studentët zhvillojnë dhe ekspedita mësimore. Në të dy rastet departamentet angazhojnë pedagogë që ndjekin studentët në praktika mësimore apo ekspedita. Këtë angazhim pedagogët e parashikojnë në formularin që bëjnë për ngarkesën vjetore të punës së tyre.⁴² Dërgimi i studentëve në praktika mësimore apo ekspedita mësimore bëhet sipas një procedure standarde midis Departamentit-Dekanit dhe në rastin e ekspeditave edhe me zyrën e prokurimeve në institucion.

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi III.4 - Njësia e institucionit angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtijshëm të personelit të tij

Angazhimi në veprimtaritë kërkimore- shkencore dhe kualifikimi i vazhdueshëm janë pjesë e rëndësishme e punës së pedagogut. Rritja e cilësisë së mësimdhënies ka për bazë edhe arrijtjet në punët kërkimore-shkencore të realizuara nga pedagogët e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.

FEF-i është i angazhuar maksimalisht për të nxitur kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtijshëm të personelit të tij. Ai mbështet zhvillimin e konferencave shkencore nga njësitet bazë; pjesëmarrjen e pedagogëve në konferenca dhe aktivitete të rëndësishme shkencore jashtë vendit të cilat pasqyrohen në faqen zyrtare të UNIKO dhe FEF.

Gjithashtu pedagogët në (FEF)UNIKO, gëzojnë të drejtën të përfitojnë vitin sabatik të paguar, e parashikuar në rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore e universitetit “Fan S. Noli” dhe në Statutin e UNIKO.

Duke njohur sfidat me të cilat ballafaqohet sot shoqëria jonë, UNIKO është përkushtuar për të siguruar arritje të qëndrueshme nëpërmjet programeve të kërkimit dhe zhvillimit, të cilat janë të hapura për të gjithë stafin. Në faqen zyrtare të UNIKO disponohet një bazë të dhënash për të gjithë të programet e studimeve të ofruara nga FEF-i sipas cikleve.

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE

Standardi IV.1 - Njësia e institucionit ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj

Në programet e studimit, të ofruara në FEF, pranohen për t'u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kushte:

Vërtetojnë me dokument zyrtar zotërimin e dëftesës së pjekurisë ose të diplomës përkatëse të shoqëruar me certifikatën e notave që bën të mundur regjistrimin në programin e studimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas rregullores së programit të studimit përkatës;

Dorëzojnë dokumentet e nevojshme sipas përcaktimeve të fakultetit;

Plotësojnë të gjitha kriteret e pranimi të përcaktuara nga organet drejtuese të FEF-it;

Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, duhet të ndjekin procedurën e njohjes së diplomës në MASR, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kryejnë pagimin e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose të plotë sipas kushteve dhe përcaktimeve të vendosura nga SA;

Renditja e kandidatëve fitues, bazohet në Nenin 76, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe realizohet nga komisioni i ngritur pranë Departamentit

Në FEF ofrohen lloje të ndryshme bursash, si bursa sociale për shtresat në nevojë, bursa të pjesshme, bursa ekselence për studentët me rezultate të larta gjatë studimeve etj.

Renditja e kandidatëve fitues, bazohet në Nenin 76, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe realizohet nga komisioni i ngritur pranë Departamentit.

Departamentet nëpërmjet veprimtarive konkrete bashkëpunuese me shkolla të mesme të qytetit realizojnë promovimin e fakultetit dhe programeve që ofron ai

Të gjitha kriteret bëhen publike për kandidatët dhe janë të shpallura në faqen zyrtare të institucionit.

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi IV.2 - Njësia e institucionit informon studentët në lidhje me politikat e punësimit

Qendra e Karrierës dhe Alumni ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Qendra e Karrierës dhe Alumni është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm.

Kjo zyrë ka tagrin për të krijuar kontakte të shumta me kompani dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata

QKA gjurmon studentët lidhur me punësimin e tyre apo vazhdimin e programeve të cikleve pasardhëse. GVB vlerëson se shërbimi i kujdesit ndaj studentit shtrihet nga momenti i regjistrimit të studentit e deri në diplomimin e tij. Krahës këshillimit që ofrohet nga personeli akademik përmes këshillimit akademik, studenti në FEF mund t'i drejtohet edhe Qendrës së Karrierës dhe Alumni, për të marrë informacion dhe këshillim akademik për procesin mësimor dhe aktivitetet studentore brenda e jashtë FEF-it/UNIKO-së. Vëmendje e veçantë i kushtohet mendimit dhe kërkesave të studentëve ekselentë, me të cilët janë zhvilluar vazhdimisht fokus grupe për të marrë informacion në lidhje me aspektet që kanë nevojë të përmirësohen.

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi IV.3 - Njësia e institucionit disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit të ciklit të parë

Në UNIKO është ngritur Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit, ku Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës dhe Sektori Juridik dhe Arkiv- Protokollit janë

përgjegjës për përpunimin e statistikave në nivel institucioni, duke u koordinuar me Sekretaritet Mësimor të fakulteteve dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Financës. Universiteti mban rekorde të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar, studentët me bursë, studentët e transferuar, ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër, ata që janë çregjistruar, si edhe studentët e diplomuar për program studimi. Zyra e Karrierës dhe Alumni mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre. Njësia disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programeve të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim; Statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar dhe për numrin e studentëve të diplomuar; Për tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programeve apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi IV.4 Njësia e institucionit angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve

Qendra e Karrierës dhe Alumni ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Qendra e Karrierës dhe Alumni është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm.

Kjo zyrë ka tagrin për të krijuar kontakte të shumta me kompani dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata. QKA gjurmon studentët lidhur me punësimin e tyre apo vazhdimin e programeve të cikleve pasardhëse

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

V- NJËSIA E INSTITUCIONIT OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI

Standardi V.1- Njësia e institucionit vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij

Biblioteka ka një fond prej rreth 15 mijë libra e revista, me rreth 6 mijë tituj, të cilat shfytëzohen nga studentë e pedagogë të fakultetit . Rreth 3 mijë libra e revista nga fondi i bibliotekës, ofrohet në gjuhë të huaj (kryesisht në anglisht, frëngjisht e italisht) dhe, rreth 12 mijë, në gjuhën shqipe. Fondi i librave dhe revistave është i klasifikuar sipas natyrës së departamenteve dhe fushave përkatëse të studimit. Librat që ofron kjo bibliotekë janë të ndryshëm në përputhje me kërkesat. Tematika e tyre është e gjerë, kryesisht janë libra shkencorë dhe artistikë. Ka përgjithësisht libra për gjuhësinë, letërsinë, historinë, gjeografinë, psikologjinë, edukimin, studime shkencore dhe albanologjike, tema disertacioni, revista, buletine etj. jo drejtohet nga një punonjës i kualifikuar e trajnuar për të përmbushur të gjitha proceset e punës në bibliotekë. Biblioteka, e cila shërben njëkohësisht si sallë studimi me fonde të hapura , është e pajisur me kompjutera, internet si dhe me sistem ngrohje që u vjen shumë në ndihmë studentëve për lexim, studim e fotokopje të materialeve të ndryshme bibliotekare.

Biblioteka frekuentohet prej studentëve të sistemit me dhe pa shkëputje, studentë të masterit dhe pedagogëve, jo vetëm për të huazuar libra, por dhe për të studiuar në sallë.⁶⁰ Në fakultet funksionon dhe Biblioteka e Qendrës së Ekselencës me një fond të specializuar librash dhe revistash në fushën e didaktikës dhe metodologjisë së mësimdhënies në shqip e gjuhë të huaja. Biblioteka e Qendrës së Ekselencës me një fond 190 tituj (shqip) 490 tituj (gjuhë të huaj).⁶¹ Studentët mund të shfrytëzojnë dhe një pjesë të konsiderueshme të fondit të librave në bibliotekën shkencore të vendosur pranë Rektoratit. Prej datës 1 mars 2018, stafit mësimdhënës, studentëve të Universitetit “Fan S. Noli”, si dhe komunitetit të Korçës, u ofrohet një mundësi e re qasjeje në Bibliotekën Digjitale ProQuest.

UNIKO bleu të drejtën e anëtarësimit në këtë Bibliotekë për periudhën 1 mars 2018 deri më 28 shkurt 2019, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit lidhur midis UNIKO dhe ProQuest. Shërbimi do të jetë aktiv për stafin në vendin e punës, për studentët dhe për komunitetin në mjediset e Bibliotekës Universitare. Në Bibliotekën Digjitale ProQuest, gjendet një literaturë bashkëkohore, e cila mbulon fushat parësore të kërkimit në Universitet, si dhe konkretisht edhe në fushën e edukimit, shkencat filologjike, shkencat sociale, etj. Orari i shpallur gjatë ditëve të javës është 8:00- 16:00. Studentët dhe pedagogët kanë kartelat e tyre personale në bibliotekë. Çdo student apo pjesëtar i personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, si dhe komuniteti kanë të drejtë të bëhen anëtare të bibliotekës universitare. Gjithashtu studentët mund të regjistrohen me llogarinë e tyre të sistemit ESSE3 në shërbimin U- Library ku mund të kenë akses shumë të gjerë në literaturë elektronike

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi V.2- Njësia e institucionit vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik

FEF ka aktualisht në përdorim 2 laboratorë mësimorë.

1 laborator të gjuhëve të huaja me kapacitet 24 vende, të pajisur me projektor dhe sistem të instaluar fonie. (Auditori 321)

1 laborator digjital i gjuhëve të huaja me kapacitet 30 vende, i pajisur me projektor (Auditori 326)

1 amfiteatër me 220 vende me pajisje audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, ku përfshihen PC-te projektorët, dhe sistemi i fonisë.

Salla auditorësh me kapacitet prej 50-100 vendesh, të gjitha të pajisura me projektor

Salla seminaresh me kapacitet prej 40-60 vendesh, të cilat janë të pajisura me projektor.

1 Qendër Ekselence e pajisur me 2 videoprojektorë, 1 smart border, 5 kompjutera, 1 printer, 1 fotokopje, bibliotekë të specializuar në fushën e didaktikës dhe metodologjisë së mësimdhënies 1sallë konferencash 50 vende të pajisur me dy videoprojektore, smartborder, me sistem video- konference; 1 mediatekë të Gjuhëve të Huaja të pajisur me projektor, TV, DVD dhe magnetofon; 1 bibliotekë e cila shërben njëkohësisht si sallë studimi me fonde të hapura , është e pajisur me kompjutera, internet si dhe me sistem ngrohje që u vjen shumë në ndihmë studentëve për lexim, studim e fotokopje të materialeve të ndryshme bibliotekare.

Sekretaria Mësimore: Është njësia pranë së cilës zhvillohet procesi administrativ brenda Fakultetit, e cila është e pajisur me paisjet e duhura për zhvillimin normal të punës administrative, dhe konkretisht 2 sete Kompjuterash, 1 printer dhe 1 printer – fotokopje. Pranë sekretarisë mbahet edhe një pjesë e Arkivit, si edhe regjistrat bazë të shkollës.

Zyra e informacionit për studentë, 2 sete kompjuterash, 1 printer-fotokopje

Departamentet: Në total janë 9 salla departamentesh të pajisura me të gjithë mjetet e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të tyre si sete kompjuterike, printer SharePoint etj.

Zyra e Dekanit: -1- në të cilën Dekani kryen të gjithë veprimtarinë e tij administrative, të pajisura me 1 set Kompjuter, 2 printera, rafte arkivimi, bibliotekë personale, TV.etj. Në parashikim të zyrës së dekanit punon

asistentja e tij, e cila shfrytëzon 1 set Kompjuter, 1 printer, 1 fotokopje, raftë arkivimi
Mjediset e fakultetit janë të mbuluara me sinjal WiFi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë webin.
Paisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit. Laboratorët e gjuhës së huaj janë paisur me softwarët përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mire programit mësimor

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME

Standardi VII.1 - Njësia e institucionit garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet

Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programeve, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;

Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit, brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

Analiza

FEF ka kërkuar në vazhdimësi kontributin e personelit akademik për hartimin e programeve të reja që vlerësohen me interes për tregun e punës dhe zhvillimin e institucionit, si edhe për përmirësimin e programeve ekzistuese. Referuar kurrikulave të programeve të studimit që ofrojnë, departamentet propozojnë në çdo fillim viti akademik ndryshime në kurrikula që lindin si domosdoshmëri e nevojave të tregut, zhvillimit të kompetencave profesionale si edhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

Në departamente dhe më ngushtë në gruplëndë trajtohen në detaje çështjet e hartimit të programeve të lëndëve, sigurimi i shmangies së mbivendosjes së temave në lëndë të përafërta ose të ngjashme, si dhe nga njëri cikël studimi në tjetrin.

Çdo departament përcakton fushat prioritare të kërkimit.¹⁷² Propozimet për ndryshime në kurrikul, diskutohen në mbledhjet e brendshme të departamenteve dhe pastaj në dekanat. Dekanati i propozon për miratim në Senatin Akademik.

Tabela .., faqe..

¹⁷² Anex IX. Dok. 9.6. Dokumenti i përcaktimit nga departamentet i fushave të kërkimit.

Shtojca

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

Standardi VII.2 - Njësia e institucionit garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtijshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

FEF në mënyrë institucionale si fakultet por edhe në kuadër të UNIKO për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunim me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët partnerë¹⁷³

Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtijshme në bashkërendim me punëdhënësit^{174,175,176}; Universiteti i Korçës bashkëpunon me universitete të njohura në mbarë botën përmes rrjeteve ndërkombëtare, platformave të bashkëpunimit si në aspektin e kërkimit dhe edukimit. Fushat e bashkëpunimit shtrihen në drejtim të:

- Njohuri dhe përvojës – benchmarking
- Projekteve të përbashkëta
- Shkëmbimeve të ndërsjella - studentët dhe stafi
- Vendosi së bashkëpunimit në projekte kërkimi e zhvillimi
- Forcimi i kontakteve në fushat e edukimit dhe kërkimit shkencor

Tregues të matshëm:

- ✓ Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar¹⁷¹
- ✓ Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

¹⁷¹Anex IX. Dok. 9.5. <http://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor> : Database: Bashkëpunime aktive; Marrëveshje Kombëtare; Marrëveshje Rajonale; Marrëveshje Ndërkombëtare; Marrëveshje Erasmus

Analiza

GVB vëren se FEF ka krijuar lidhje të qëndrueshme me një sërë institucionesh të administratës publike që janë palë interesi për programet që ofron për të lehtësuar procesin e praktikave profesionale të studentëve, si edhe punësimin e ardhshëm të tyre. Në këtë kuadër, UNIKO zhvillon çdo vit edhe Panairin e Punës, pjesë e të cilit është dhe FEF, për të lehtësuar kontaktin e studentëve me kompani nga më të rëndësishmet në Shqipëri, me synim punësimin e mundshëm të studentëve në to. Edhe periudha kohore e zhvillimit të Panairit të Punës, përkon pikërisht me fundin e vitit akademik për të krijuar sa më shumë mundësi për studentët në prag

diplomimi.

Praktikat profesionale u zhvilluan në institucione të ndryshme, sipas fushave të studimit, në periudha të ndryshme, si dhe me kohëzgjatje të ndryshme, në varësi të nevojave specifike, të programeve përkatëse. Për realizimin me sukses të praktikës profesionale, studentët përgatiten edhe teorikisht në lidhje me zhvillimin e saj.

Studentët praktikantë, përveç punonjësve të institucioneve ku zhvillohen praktikat, udhëhiqen dhe vëzhgohen nga pedagogë të ndryshëm, të përcaktuar nga departamentet përkatëse.

Në përfundim të praktikës, studentët u vlerësuan objektivisht mbi bazën e kriterëve dhe dokumentacionit të kërkuar të praktikës si psh: Formulari i Vlerësimit nga mësuesi mentor, modelimi i detajuar i orëve mësimore të zhvilluara nga ata gjatë kësaj praktike, si edhe vlerësimi i marrë gjatë praktikës nga pedagogët në fushat përkatëse.

Në kuadër të fuqizimit të FEF, me qëllim për të hapur programe të reja ndërdisiplinore ndërmjet bashkëpunimit të departamenteve të Fakultetit, bashkëpunimit ndërmjet departamenteve të ndryshme të Universitetit tonë por edhe mes bashkëpunimit me Univeresitete të tjera, janë kryer takime nga Institucioni i Dekanit me Konsullatën greke në Korçë, me Sekretaren e Shtetit të Rumanisë dhe Ambasadorin e Rumanisë në Shqipëri, me Atasheun Kulturor francez, me Ambasadorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut etj. Në këto takime u shkëmbyen mendime lidhur me mënyrat e bashkëpunimit me këto institucione për të ndihmuar e fuqizuar Fakultetin. Gjithashtu u realizua një bashkëpunim me Institutin Gëte e së fundmi u nënshkrua Marrrëveshja e Bashkëpunimit të Universitetit tonë me Universitetin e Janinës.

Departamentet përkatëse janë informuar në takimet e vazhdueshme dhe mbledhjet e brendshme te departamenteve për të gjitha marrëveshjet e lartpërmendura, e janë hedhur ide për thellimin e mëtejshëm te bashkëpunimit me homologët tanë përtej kufijve. Synohet që të forcojmë bashkëpunimin duke shkëmbyer eksperiencë të mësimdhënies bashkëkohore midis nesh përmes: rinovimit të kurrikulave të programeve tona të studimit, hapjes së programeve të reja në bashkëpunim të ndërsjelltë në nivel Bachelor e Master duke ftuar pedagogë nga departamente e fusha studimore sipas risive kurrikulare që synohen të arrihen, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta, organizimin e shkollave verore si dhe mobilitet e studentëve dhe stafit akademik.

Tabela .., faqe..

¹⁷³ Anex IX. Dok. 9.7. <http://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor> : Database: Bashkëpunime aktive; Marrëveshje Kombëtare; Marrëveshje Rajonale; Marrëveshje Ndërkombëtare; Marrëveshje Erasmus

¹⁷⁴Anex IX. Dok. 9.8. <http://www.unkorce.edu.al/sq/content/departamenti-i-gjuh%C3%ABve-t%C3%AB-huaja-zhvilloi-tryez%C3%ABn-e-rumbullak%C3%ABt-%E2%80%9Cgjuh%C3%ABt-e-huaja-dhe-tregu-i>

¹⁷⁵Anex IX. Dok. 9.9. <http://www.unkorce.edu.al/sq/content/uniko-p%C3%ABr-her%C3%AB-t%C3%AB-par%C3%AB-prezantohet-n%C3%AB-panairin-e-punes-2018-me-nj%C3%AB-ofert%C3%AB-t%C3%AB-re-akademike>

¹⁷⁶ Anex IX. Dok. 9.10. <https://www.unkorce.edu.al/sq/trajtime>

Shtojca

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Njësia e institucionit garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimit

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin Programet e studimit që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

UNIKO ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional Vendim të Bordit të Akreditimit nr.65, datë 21.09.2017^{88,89} të shoqëruar me certifikatën e akreditimit.⁹⁰ Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe NJSBC, tërheqjes së mendimit të studentëve, si edhe bashkëpunimit me ASCAL- in dhe struktura të tjera shtetërore. Kujdes i kushtohet zbatimit me rigorozitet të legjisla- cionit në fushën e arsimit, me fokusim të veçantë në standardet e cilësisë për të gjitha nivelet.⁶³

Gjithashtu përfaqësues të Këshillit Studentor të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës, bëhen pjesë e takimeve informuese për “Sondazhin Kombëtar të Studentëve”, organizuar nga ASCAL dhe BA.⁹¹ Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë është pjesë përbërëse e strukturës organizative të UNIKO-së, brenda Drejtorisë së Kurrikulave Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor. SKSC-ja përfshin dy drejtime pune që janë pandashmërisht të lidhur me njëri- tjetrin: “Zhvillimin e Programeve Mësimore” dhe “Vlerësimin Institucional”. Në këtë kuadër, ky sektor vazhdon të menaxhojë një rrjet të Sigurimit të Cilësisë në shkallë fakulteti dhe universiteti, i cili funksionon i mirëkoordinuar si në nivelin bazë të infrastrukturës institucionale, ashtu edhe në menaxhimin e burimeve njerëzore.^{92,93}

Tabela ..., faqe..

⁸⁸ Anex VI. Dok.6.8. <https://www.unkorce.edu.al/sq/article/akreditimi-institucional>

⁸⁹ Anex VI. Dok.6.9. Anex VII. Dok. 7.8. Vendim nr.65, datë 21.09.2017 për Akreditimin e parë të IAL Universiteti “Fan Noli” Korçë
https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/VENDIMI%20NR.%2065%20 DATE%2021.09.2017%20PER%20 OAKRE DITIMIN%20E%20PARE%20TE%20UNIKO_0.pdf

⁹⁰ Anex VI. Dok.6.10.

<https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/CERTIFIKATA%20E%20AKREDITIMIT. pdf>

Rekomandime të NJSBC:

(Rekomandimet përkatëse të çështjeve që kanë nevojë për përmirësim)

KONKLUSIONE TË NJSBC:

Për sigurimin e cilësisë në FEF, tregohet kujdes i veçantë. Ai, ashtu si në gjithë strukturat e UNIKO-së konsiderohet përparësi për secilin punonjës, ndiqet me kujdes nga strukturat drejtuese dhe monitorohet në mënyrë permanente nga NJSBC. Përvoja e derisotme dëshmon për nevojën e një kontrolli të tillë, për domosdoshmërinë e një njësie të posaçme monitorimi, që orienton institucionin drejt plotësimit të standardeve të cilësisë dhe shërben si forcë shtytëse për një performancë në rritje në nivel institucioni dhe për çdo individ.

Feedback –u i marrë nga kontakti me ish-studentët e tij, Alumni, të cilët janë mësues në shërbim dhe zhvillojnë pranë Qendrës së Formimit të Vazhduar trajnime të përvitshme në sesione të ndryshme gjatë vitit në kuadër të zhvillimit profesional, sipas akteve ligjore në fuqi, janë një element i rëndësishëm që mbahet parasysh lidhur me cilësinë e programeve që ofron fakulteti.

KONKLUSIONE TË NJSBC:

GVB vëren se FEF ka krijuar lidhje të qëndrueshme me një mjaft institucione të administratës publike që janë palë interesi për programet që ofron për të lehtësuar procesin e praktikave profesionale të studentëve, si edhe punësimin e ardhshëm të tyre. Kë këtë kuadër, UNIKO zhvillon çdo vit edhe Panairin e Punës, pjesë e të cilit është dhe FEF, për të lehtësuar kontaktin e studentëve me kompani nga më të rëndësishmet në Shqipëri, me synim punësimin e mundshëm të studentëve në to. Edhe periudha kohore e zhvillimit të Panairit të Punës, përkon pikërisht me fundin e vitit akademik për të krijuar sa më shumë mundësi për studentët në prag diplomimi.

ANALIZA SWOT

ANALIZA SWOT

Pikat e forta të brendshme potenciale	Pikat e dobëta të brendshme potenciale
---------------------------------------	--

Funksionimi i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë brenda kuadrit institucional të UNIKO dhe programet që ofron BA mbështeten në një vizion të qartë, mision të mirëpërcaktuar dhe plan të zhvillimit strategjik të qartë dhe bashkëkohor. Dokumenti i Planit Strategjik të Zhvillimit të institucionit është një dokument që orienton drejt dhe me realizëm zhvillimin në kontekstin e institucionit, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Programet garantojnë përgatitjen e studentëve në përputhje me objektivat e përcaktuara. Ato janë ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin e institucionit, nevojat e tregut, objektivat e reformës së arsimit të lartë në vend dhe të Procesit të Bolonjës: Për një pjesë të mirë të tyre është marrë edhe mbështetje dhe ekspertizë nga përvoja më e mirë bashkëkohore vendase dhe e huaj.

Programet e studimit përditësohen dhe respektojnë standardet akademike. Plani mësimor, syllabuset metodat e mësimdhënies dhe të nxënies janë sipas kërkesave të standardeve akademike, konform legjislacionit në fuqi. Programet janë përshtatur sipas interesave të studentëve për të garantuar konkurrimin në tregun e punës. Personeli është tejet mbështetës dhe angazhohet në debate në shkallë universiteti. Personeli akademik me tituj dhe përvojë domethënëse është pikë mbështetjeje e fortë. Qasje pozitive kundrejt hartimit të programit dhe kurrikulës, që mbështet zhvillimin e mundësive për punësimin e të diplomuarve në

Numri i studentëve jo në nivele të kërkuara dhe të planifikuara apo sipas pritshmërive të kërkuara në programe të caktuara.

Prioriteti dhe koordinimi i fushave të kërkimit në shkallë departamenti midis stafit akademik dhe studentëve.

Nevojë për përfshirje më të madhe dhe ndërgjegjësim të studentëve për rolin që luajnë në sigurimin e cilësisë së veprimtarisë akademike. Ende nuk është gjetur pika e duhur e takimit të kërkimit shkencor me mësimdhënien.

kontekstin e nevojave vendore . Mjedis pozitiv i të nxënit për studentët Zhvillim i ofertës kurrikulare dhe infrastrukturës mbështetëse. Tradita dhe përvoja e fituar, për një periudhe të gjatë si fakultet që përgatit specialistë në fushën e edukimit. Rritja e cilësisë së kandidatëve që aplikojnë për programet e ciklit të parë. Transmetimi tek studentët i një informacioni cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter teorik e praktik, duke synuar arritjen e kompetencave profesionale e personale, me qëllim përgatitjen e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të debatojnë e marrin vendime të sakta, të orientohen shpejt përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen. Infrastrukturë funksionale që përpiket drejt trendeve bashkëkohore. Bashkëpunim i institucionalizuar me institucione homologe dhe institucione të tjera bashkëpunuese për të realizuar objektivat për kërkimin, shkëmbimin e eksperiencave dhe punësimin e të diplomuarve. Hartimi dhe funksionimi i një dokumentacioni ligjor dhe pedagogjik në nivel institucional dhe fakulteti, si tregues që dëshmon për një veprimtari të institucionalizuar, të strukturuar dhe të standardizuar	
Si u përdorën pikat e forta në ngritjen e strategjive e uljes së rreziqeve dhe përmirësimit të pikave të dobëta	Cilat janë strategjitë e mundshme në përmirësimin e pikave të dobëta të evidentuara. (sugjerime)
Kthimi i realizimit të konferencave studentore periodike , si një mundësi e mirë. Nxitja e mobiliteteve mësimdhënëse dhe trajnuese për stafin akademik dhe studentët. Promovimi i përvojave më të mira në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor përmes veprimtarive me ekspertë dhe përvoja ndër-kombëtare. Organizimi i veprimtarive shkencore të mirorganizuara në formën e konferencave, seminareve shkencore perodike; ëorkshopeve, shkëmbim stafi etj;	Të këmbëngulet në zbatimin e një strategjie për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të fushave të kërkimit, të identifikuar si prioritet. Konsolidimi i programeve ekzistuese në ciklin BACHELOR dhe MASTER duke përmirësuar kurrikulën ekzistuese dhe njësuar atë me kurrikulat e universiteteve të tjera brenda vendit dhe në rajon, me gjithë përpjekjet, mbetet ende sfidë;

Mundësitë e jashtme potenciale	Rreziqet e jashtme potenciale
Eksperienca e fituar rrit mundësitë për të aplikuar dhe për t'u bërë pjesë e projekteve të reja duke përfshirë gjithnjë e më shumë studentët. FEF gëzon një imazh pozitiv dhe të mirë në publik të cilin synon ta përforcojë dhe të ndërtojë mbi të të ardhmen e tij si një fakultet tërheqës për studentët Mundësi për ndjekjen e karrierës studentore edhe pas futjes në shërbim nëpërmjet takimeve, trajnimeve që zhvillohen në QFV dhe gjurmimi nga QKA.	Unifikimi i kurrikulave të programeve të njëjta ose të përafërta me fakultete të tjera Domosdoshmëria për diversifikimin e burimeve të financimit Pengesa të tjera nuk konstatohen

PJESA II

TREGUES TË MATSHËM

TABELAT PËRMBLEDHËSE

Për vitin akademik 2021-2022, personeli akademik i FEF ka planifikuar dhe realizuar ngarkesën mësimore, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtaritë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.

Personeli akademik dhe studentët, pas kthimit në auditore patën lehtësi komunikimi dhe realizim më të mirë të procesit mësimor. Stafi akademik i FEF bëri përpjekjet maksimale për të plotësuar njohuritë e studentëve. Me gjithë vështirësitë e krijuara, nga periudha e mësimit online si për stafin akademik ashtu dhe për studentët, u arrit të realizohej me sukses procesi i mësimdhënies. U evidentua pjesëmarrje e kënaqshme e studentëve, si dhe interes në rritje për të ndjekur hap pas hapi procesin mësimor.

Digjitalizimi i sistemit të brendshëm të menaxhimit të të dhënave të studentëve filloi në vitin akademik 2021-2022 me Sistemin e ri Pitagora për të automatizuar proceset e sekretarive mësimore dhe shërbimeve ndaj studentëve pas përfundimit të afatit të sistemit ESSE3. Pedagogët zhvilluan orë trajnimi për njohjen dhe përdorimin e sistemit të dhe nuk pati probleme dhe vonesa për studentët.

Monitorimi i cilësisë së mësimdhënies ka qenë proces i vazhdueshëm. Në plotësim të standardeve të cilësisë, ku ky aspekt zë një vend të veçantë, janë ngritur dhe mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, duke bërë pjesë dhe studentët, si nëpërmjet marrjes së mendimit/sondazheve.

Diplomimi i studentëve të të gjitha cikleve, u realizua me sukses, dhe këtë e treguan rezultatet e mira si në provimin e formimit, ashtu dhe në mbrojtjen e temave të diplomave.

Gjatë këtij viti akademik, FEF përvijoi aktivitetin e vet mësimor dhe kërkimor në lidhje me drejtimet e mëposhtme:

- Ofroi programe studimi që formojnë specialistë në fushat e mësimdhënies dhe të nxëniet të këtyre fushave. (FEF ofron 7 programe studimi Bachelor, 6 programe Master Profesional, 1 Master Shkencor dhe 2 programe 2 vjeçare profesionale).
- Siguroi vazhdueshmërinë e cilësisë së brendshme dhe ruajtjen e konkurrencës së diplomave në kontekstin e Arsimit të Lartë në vend dhe më gjerë. (Gjatë vitit akademik 2021-2022 në FEF u akredituan dy programe studimi “Arsimi Fillor” dhe “Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”, si dhe presim vendimin e Bordit të Akreditimit dy programe “Histori-Gjeografi” dhe “Gjuhë-Letërsi”).
- Rriti cilësinë e kërkimit shkencor dhe e vuri atë në dispozicion të zhvillimit shoqëror dhe kulturor të Rajonit. (Gjatë vitit akademik 2021-2022 stafi akademik i FEF ishte fitues i disa projekteve kombëtare e ndërkombëtare. Departamenti i GJ-H fitoi disa projekte si: DigiKomp projekti drejt të mësuarit me kompetencën digjitale (AKKSHI), ketu per
- Trajnoi mësimdhënës që punojnë në të gjitha zonat e Rajonit dhe më gjerë. (shiko kapitulli 3, pika 8.
- Gjatë vitit akademik 2021-2022, stafi akademik dhe studentë të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, zhvilluan mobilitete me disa universitete te huaja. Kjo i shëben stafit akademik dhe studentëve jo vetëm për shkëmbim dijes personale por edhe për ti trasmetuar këto njohuri në FEF tek kolegët dhe studentët e tjerë.

Mobilitete të stafit akademik	2021-2022	Mobilitete të studentëve	2021-2022
North University Centre of Baia Mare,	14 pedagogë	North University Centre of Baia Mare,	3 studentë
University of Palermo, Italy,	1 pedagog		
		University for Foreigners of Perugia, Italy	2 studentë
"St. Cyril and Methodius" University of Veliko Tarnovo, Bulgaria,	2 pedagogë	"St. Cyril and Methodius" University of Veliko Tarnovo, Bulgaria,	2 studentë.
University of Panteion, Aristotle" University of Thessaloniki	3 pedagogë 1 pedagog		

Kërkimi shkencor pas kushtëzimit nga shpërthimi i pandemisë rifilloi normalisht. Gjatë këtij viti akademik pedagogët e FEF kanë realizuar këto botime:

TABELË PËRMBLEDHËSE PËR NJËSINË

Emërtimi	Fakulteti
1. Projekte (pjesëmarrje)	6 projekte/staf
2. Konferenca Ndërkombëtare	79 punime/
3 Konferenca kombëtare	16 punim/
4. Sesion shkencor	13 punime/
5. Seminar	12 seminare/ pjesëmarrës
7. Workshop	7 autorë
8. Tekste	1 punime
9. Monografi	2
10. Dispensa	1 punime+ i org. dispense
11. Artikuj	26 artikuj
12. Kongres	1

Ndërkohë, krahas mësimdhënies dhe veprimtarisë shkencore në departamentet përkatëse Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë për vitin akademik 2020-2021 realizoi me sukses një sërë veprimtarish shkencore, sidomos me fokus studentët dhe maturantët.

1.Veprimtari të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë për vitin akademik 2021-2022

1. Në datën 24 shtator 2021, departamenti i Edukimit, organizoi një tryezë të rrumbullakët me temë: “Social educators in inclusive societies”
2. Në datën 4 tetor 2021, në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë u zhvillua një veprimtari letrare për promovimin e librit të autorit Visar Zhiti me titull “Dorëshkrimet e fshehta të burgut”
3. Në datën 15 tetor 2021 prof. as. dr. Jonela Spaho promovoi monografinë e saj “Kristo Floqi, jeta dhe vepra e tij”.
4. Në datën 15 tetor 2021 departamenti i Edukimit zhvilloi Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Early Childhood Education and Care: Challenges and Perspectives” në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave të Edukimit të Universitetit “Giovanni Maria Bertin” të Bolonjës.
5. Në datën 6 nëntor 2021 në mjediset e Bibliotekës “Kongresi i Manastirit”, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë u prezantua libri i përkthyesit Sokol Çunga “Antologji e poezisë bashkëkohore greke”
6. 12 nëntor 2021, FEF në bashkëpunim me Fakultetin e Historisë Dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës zhvilloi Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Politikat Gjuhësore mbi Pakicat në Ballkan-Arritje dhe Perspektiva”
7. Në datën 2 dhjetor 2021, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë organizoi simpoziumin shkencor-kulturor “Gjergj Fishta në 150-vjetorin e lindjes”, në kuadër edhe të veprimtarive me rastin e 50- vjetorit të themelimit të Universitetit “Fan S. Noli”.
8. Në datën 7 dhjetor 2021, në mjediset e Amfiteatrit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë u zhvillua një leksion i hapur me studentë të programeve “Master” në “Mësuesi”. Lektorët Arjan Kamburi dhe Anjeza Vila trajtuan temën “Aspektet psikologjike të edukimit”
9. Në datën 16 dhjetor 2021, në mjediset e Amfiteatrit të FEF u zhvillua një veprimtari ndërgjegjësuere në të cilën u prezantua dokumentari “Varret pa emër”. Veprimtaria u organizua nga Fondacioni “Kujto. al” në bashkëpunim me departamentin e Histori-Gjeografisë
10. Në datën 17 dhjetor 2021, në mjediset e FEF u promovua libri i autorit Mal Berisha “Ambasador i pushtetit të butë”.
11. Në datën 17 janar 2022 në mjediset e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë organizoi një veprimtari për promovimin e monografisë shkencore “Caktuesori në gjuhët e Ballkanit” të pedagoges, dr. Hysnie Haxhillari.
12. Në datën 18 shkurt 2022 në mjediset e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë u zhvillua një Sesion Shkencor me temë: “Kosova- Shtet: Sfidë dhe Arritje- Rruga Drejt Pavarësisë” organizuar nga

departamenti i Histori-Gjeografisë në bashkëpunim me Universitetin “Hasan Prishtina”, Kosovë dhe me Universitetin e Tiranës.

13. Në datën 4 mars 2022, departamenti i Histori-Gjeografisë organizoi në mjediset e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë promovimin e botimit “Shtigjet e përgjakura” të shkrimtarit Ali Daci.

14. Në datën 2 prill 2022, departamenti i Edukimit, në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit për autimin zhvilloi cikël orësh të hapura me temë; “Autizmi-Nga Ndërgjegjësimi Drejt Pranimit”

15. Në datën 8 prill 2022 në kuadër të promovimit të stafit akademik, departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë zhvilloi leksionin e hapur: “Një këndvështrim antropologjik mbi veprën e Mitrush Kutelit” nga pedagogu, dr. Neli Naço.

16. Në datën 28 prill 2022, departamenti i Histori-Gjeografisë i Universiteti “Fan S. Noli” organizoi, me studentë dhe maturantë të ftuar nga Kolegji “Preka”, veprimtarinë “Pakti Evropian për Klimën”.

17. Në datën 29 prill 2022 në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë u zhvillua një veprimtari për prezantimin e romanit “Bijat e Gjeneralit” të shkrimtares dhe përkthyeses Mimoza Hysa.

18. Nga data 28 prill-13 maj 2022, pedagogia e Universitetit Teknik të Cluj-Napoca, Rumani, Ligia Mara Tomoiagă zhvilloi leksione me studentë të programeve Bachelor dhe Master në “Gjuhë Angleze” të departamentit të Gjuhëve të Huaja, Universitetit “Fan S. Noli”.

19. Nga data 16-20 maj 2022, departamenti i Edukimit i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë në kuadër të veprimtarisë së përvitshme “Edukim nëpërmjet kinemasë” organizon “Javën e filmit” në të cilin, këtë u ftuan të marrin pjesë studentë të të gjitha departamenteve të këtij fakulteti.

20. Në datat 20-21 maj 2022 u zhvillua kupa Universitare “Fan S. Noli” në volejboll për femra me pjesëmarrjen e ekipeve të volejbollit të femrave të: Universitetit “Hasan Prishtina” Universitetit të Tiranës Universitetit “Fan S. Noli” Ekipi “Korça-Volley”

21. Në datën 25 maj 2022, departamenti i “Gjuhës dhe i Letërsisë” organizoi leksionin e hapur: “Rivlerësim i disa strukturave sintaksore të shqipes, të paraqitura në botimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë “Gramatika e gjuhës shqipe II” nga prof. as. dr. Elona Çeçe.

22. Në datën 1 qershor 2022, studentët e programeve të studimit: “Mësuesi në Arsimin Fillor”, “Mësuesi në Arsimin Parashkollor” dhe “Edukim Fizik dhe Sporte” të departamentit të Edukimit zhvilluan lojëra argëtuese dhe edukative më fëmijët e kopshteve dhe shkollave të qytetit .

23. Në datën 3 qershor 2022, departamenti i “Gjuhës dhe i Letërsisë” organizoi tryezën e rrumbullakët me temë “Mësuesi i gjuhës dhe i letërsisë në tregun e punës” me mësues të arsimit parauniversitar në qarkun e Korçë

24. Në datën 8 qershor 2022, romani “Shtegu për tek tî” i autores Chthryn Bibeeu dhe i shqipëruar nga Dr. Eris Rusi u prezantua një veprimtari të organizuar nga FEF .

25. Në datën 9 Qershor 2022, FEF zhvilloi Konferencën e III-të studentore me punime të studentëve Bachelor dhe Master.

26. Në datën 12 korrik 2022, u zhvillua Konferenca Shkencore “Studime Semantike në fushën e Leksikut dhe të fjalëformimit në Gjuhën Shqipe” e organizuar nga Departamenti i Leksikologjisë, i Terminologjisë

dhe i Gjuhësisë së zbatuar, nga Departamenti i Gramatikës dhe Historisë së Gjuhës, pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës dhe të Letërsisë.

2. Menaxhimi i Praktikës Profesionale

Për realizimin e praktikës profesionale u hartua një plan-pune konkret në lidhje me mirë menaxhimin e saj dhe me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të këtij procesi, për përmirësimin e mëtejshëm të tij. Grupet e punës të ngritura nga departamentet, në lidhje me menaxhimin e praktikës profesionale, për vitin akademik 2021-2022, ndoqën realizimin e saj sipas rekomandimeve të raportit të vitit paraardhës. Realizimi i praktikave të studentëve u mundësua në bashkëpunim me institucionet arsimore pritëse, falë marrëveshjeve të nënshkruara nga FEF dhe DRAP.

Praktikat e studentëve, për vitin akademik 2021-2022, u zhvilluan normalisht, nëpër institucione të ndryshme, sipas fushave dhe specifikave të programeve të studimeve, si dhe sipas marrëveshjeve të lidhura paraprakisht në këtë kuadër. Studentët e programeve të studimit në fushën e mësuesisë, e zhvilluan praktikën profesionale në shkollat e arsimit parauniversitar të Qarkut Korçë.

Për vitin akademik 2021-2022 u realizuan praktika profesionale edhe për studentët e programit Bachelor në Edukim Fizik dhe sporte, përkatësisht 4 javë semestrin e parë dhe 4 javë semestrin e dytë sipas planit mësimor.

Sipas ndryshimeve të propozuara në kurrikul nga anëtarët e departamentit u mundësua praktikë profesionale në çerdhet e qytetit të Korçës (sipas marrëveshjes) për studentët e Programit Profesional “Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme”.

Praktikat e studentëve të programit dyvjeçar “Mbështetës zyre për Komunikim, Bibliotekë dhe Arkiv” u zhvilluan në Qendrën Rajonale të Formimit Profesional dhe në Qendrën e Artit dhe të Kulturës nën mentorimin e dyanshëm, të koordinatorit të programit në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit, si dhe nga punonjësit e caktuar nga institucionet e sipërpërmendura. Në këtë mënyrë studentët mundën të praktikojnë në mënyrë konkrete një pjesë të mirë të njohurive të marra në lëndët e formimit karakterizues në lidhje me përpunimin e dokumenteve fizike e digjitale.

Praktikat profesionale të Msc. “Kulturë, Media dhe Editim” u kryen në institucionet ku një pjesë e studentëve janë të punësuar.

Siç shihet nga të dhënat, praktikat profesionale zhvillohen në institucione të ndryshme, sipas fushave të studimit, në periudha të ndryshme, si dhe me kohëzgjatje të ndryshme, në varësi të nevojave specifike, të programeve përkatëse. Për realizimin me sukses të praktikës profesionale, studentët përgatiten edhe teorikisht në lidhje me zhvillimin e saj.

Studentët praktikantë, përveç punonjësve të institucioneve ku zhvillohen praktikat, udhëhiqen dhe vëzhgohen nga pedagogë të ndryshëm, të përcaktuar nga departamentet përkatëse.

Formulari i Vlerësimit u dorëzua nga pedagogu mentor te drejtoria e shkollës ku studenti kryen praktikën mësimore. Në përfundim të praktikës, studentët dorëzuan një modelim të detajuar të orëve mësimore të zhvilluara nga ata gjatë kësaj praktike. Vlerësimit të punimit iu bashkëngjiti vlerësimi i marrë gjatë praktikës nga pedagogët në fushat përkatëse.

Ekspeditat mësimore u zhvilluan në terren dhe u realizuan me detyra kursi dhe projekteve të ndryshme.

3. Mbrojtja e diplomës

Vlen për t'u theksuar fakti që cilësia e punimeve të temave të diplomës në përgjithësi ka qënë e mirë duke arritur rezultate të larta në vlerësimet e punimeve të diplomave si dhe në provimin e formimit. Temat e diplomave të studentëve u lidhën ngushtë me programet ku ata studiojnë por edhe profilin e punës që kryejnë sidomos tek studentët e Masterit shkencor.

Diplomimi në nivelin Bachelor dhe Master kryhet në dy forma:

1. me provim formimi; (u rifreskua nga të gjithë pedagoget fondi i pyetjeve)
2. me mbrojtje teme diplome (temat dhe fushat u përcaktuan nga departamentet përkatëse).

U diplomuan:

1. Studentët e programeve Bachelor
2. Studentët e programeve Master
3. Studentët e programit 2-vjeçar MBZ dhe EFFH
4. Studentët e programit Master Shkencor në KME

4. Raporte të vlerësimit të programeve

Departamenti i Edukimit, përfundoi me sukses procesin e akreditimit për dy programe studimi. Programi Bachelor në “Arsim Fillor” (4 vjet) me vendim të bordit të akreditimit datë 16 dhjetor 2021 dhe programi profesional në “EFFH” (3 vjet) me vendim të bordit të akreditimit datë 7 janar 2022. Vendimet e mësipërme erdhën si rezultat i punës cilësore të grupeve të vlerësimit të brendshëm, të cilat dorëzuan në kohë raportet e vlerësimit të brendshëm për dy programet e studimit si dhe iu nënshtruan intervistave dhe vizitave të ekspertëve të jashtëm.

Gjatë vitit akademik 2020-2021, Departamentet e “Gjuhë-Letërsisë” dhe “Histori-Gjeografisë” nisën procesin e akreditimit të programeve Bachelor “Gjuhë-Letërsi” dhe Bachelor “Histori-Gjeografi”, në përmbushje të objektivit A.B.1, të Planit strategjik 2016-2020, të Universitetit “Fan S. Noli”. U ngritën Grupet e Vlerësimit të Brendshëm, të përbërë nga anëtarë të departamenteve, përfshi këtu edhe një student, sipas vendimeve të departamenteve përkatëse.

GVB u njohën me procesin dhe dokumentacionin e procesit. Mbledhja e materialit dhe përpunimi i të dhënave u realizua në bashkëpunim me:

- Stafin akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme,
- Studentët,
- Autoritetet drejtuese të institucionit,
- Sekretarinë mësimore të FEF,
- Drejtorinë e Kurrikulave dhe Vlerësimit të Cilësisë,
- Drejtorinë e Financës,
- Sektorin e Statistikave,
- Sektorin e Burimeve Njerëzore,
- Sektorin e Karrierës dhe Alumnit,
- Sektorin e IT-së,
- Palët e interesit.

Shkrimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) u bë në saj të bashkëpunimit të plotë të anëtarëve të GVB, në përputhje me Standardet e miratuara të cilësisë në programet e ciklit të parë (ASCAL). Drafti u

diskutua paraprakisht në departamentet përkatëse dhe sugjerimet u pasqyruan në draftin përfundimtar. Dosja e dokumentacionit bashkëngjitur RVB, u plotësua dhe klasifikua sipas natyrës së materialeve në shtojcat përkatëse.

Stafi akademik dhe administrativ dhe autoritetet drejtuese të FEF u informuan në mënyrë të rregullt në lidhje me çdo etapë të procesit të sipërpërmendur. Studentët e programeve, u vunë në dijeni të rolit të tyre në këtë proces vlerësimi.

Në datat 8 dhe 9 nëntor 2021 u zhvillua vizita e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), sipas agjendës së miratuar paraprakisht, e cila kishte parashikuar takime me Dekanin e FEF, me përgjegjësit e dy departamenteve, me anëtarët e GVB-së, me stafin akademik efektiv dhe me studentë të këtyre dy programeve studimi. Ditën e dytë u zhvilluan takime me punonjësit e Sekretarisë mësimore dhe u inspektuan mjediset (auditorët, laboratorët, biblioteka, shërbimet për studentët etj). Sipas drejtuesve të departamenteve përkatëse, i gjithë procesi shkoi në pritshmëritë e duhura dhe tani pritet raporti përfundimtar i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm.

GVJ në mars 2022 dergoi draft-raportin e vlerësimit për procesin e akreditimit të programit të ciklit të parë BA në Histori-Gjeografi dhe Gjuhë-Letërsi. Gjetjet e raportit ishin mjaft pozitive për të gjithë elementët e raportit. Si pasojë e punës së grupeve të brendshme GVB dhe GVJ pritet vlerësim pozitiv nga Bordi i Akreditimit në Ministrinë e Arsimit.

5. Vlerësime:

1. Pjesëmarrja dhe fitimi i disa projekteve në rang institucional dhe më gjerë nga pedagogët e FEF
2. Botimi i disa monografive nga pedagogët e FEF
3. Përfshirja e studentëve në aktivitete shkencore dhe kulturore të departamenteve;

6. Pikat e forta

1. Staf akademik i kualifikuar
2. Arritje të kënaqshme në fushën e kërkimit shkencor
3. Numri i kënaqshëm i mobiliteteve për shkëmbim dhe transferim përvoja
4. Organizimi i kënaqshëm i aktiviteteve shkencore, kulturore, letrare dhe sportive.
5. Mjedisë dhe infrastrukturë bashkëkohore, që krijon mundësitë për zhvillimin cilësor të punës mësimore
6. Numër i madh anëtarësimi studentësh në bibliotekën e FEF
7. Pasurimi i fondit ekzistues të bibliotekës së FEF me vepra që u vijnë në ndihmë studentëve në procesin mësimor.
9. Rishikim i vazhduar i kurrikulave dhe syllabuseve në përputhje me standardet bashkëkohore të mësimdhënies.
10. Integrimi i kërkimit shkencor me procesin e mësimdhënies

7. Pikat e dobëta

1. Krijimi i lidhjeve më të gjera me institucione të tjera kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare
2. Mungesa e marrjes së titujve nga stafi akademik

3. Rënie të numrit të të regjistruarve, për arsye të mesatares të vendosur nga MASR dhe pakësimit të numrit të maturantëve
4. Mungesë e hapjes së programeve të reja.

III. PROGRAMET E STUDIMIT

Programet e studimit që ofrohen

NR.	BACHELOR/ MASTER PROFESIONA L/ MASTER I SHKENCAVE	EMËRTIMI I PROGRAMIT	AKTIV/ JO AKTIV MBYLLU R	NR. DATA E AKTIT TË HAPJES/MBYLLJE S/ RIORGANIZIMIT
1.	Bachelor	GJUHË ANGLEZE	Aktiv	VKM Nr. 300, dt. 21.06. 1994
2.	Bachelor	GJUHË DHE KULTURË FRËNGE	Aktiv	Urdhër i MASR Nr. 273, dt. 20.07.2015 bazuar mbi Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr.56, datë 29.06.2015
3.	Bachelor	GJUHË - LETËRSI	Aktiv	VKM Nr. 402, dt. 25.05.2005
4.	Bachelor	HISTORI-GJEOGRAFI	Aktiv	VKM Nr. 352, dt. 12.05.2010
5.	Bachelor	MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR KLASA I-VI	Aktiv	Urdhër Nr. 81, dt. 25.02.2013

6.	Bachelor	MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR	Aktiv	VKM Nr. 369, dt. 10.07.1995
7.	Bachelor	EDUKIM FIZIK DHE SPORTE	Aktiv	URDHËR nr. 414, datë 29. 07. 2019
8.	Master profesional	MËSUES NË HISTORI DHE GJEOGRAFI	Aktiv	Vendimi Nr.575, datë 01.10.2018, i Senatit Akademik të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, “Për një ndryshim në vendimin nr. 162, dt. 21.02.2018 “Për riorganizimin e programeve ekzistuese të ciklit të dytë Master profesional”
9.	Master profesional	MËSUES I GJUHËS ANGLEZE	Aktiv	Shkresë Nr. 1287/1 Prot., dt 15.03.2019, e Minsitrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë për arsimin, sportin dhe rininë, Drejtoria e rregullimit, lejeve, licencave dhe monitorimit Vendimi Nr.575, datë 01.10.2018, i Senatit Akademik të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, “Për një ndryshim në vendimin nr. 162, dt. 21.02.2018 “Për riorganizimin e programeve ekzistuese të ciklit të dytë Master profesional” Vendimi Nr.29, i Departamentit të Gjuhëve të huaja, dt. 25.01.2018

10.	Master profesional	GUIDË TURISTIKE	Aktiv	VKM Nr. 636, datë 05.10.2018
11.	Master profesional	MËSUES PËR GJUHËN SHQIPE DHE LETËRSI	Aktiv	Vendimi Nr.575, datë 01.10.2018, i Senatit Akademik të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, “Për një ndryshim në vendimin nr. 162, dt. 21.02.2018 “Për riorganizimin e programeve ekzistuese të ciklit të dytë Master profesional”
12.	Master profesional	MËSUES PËR ARSIMIN FILLOR	Aktiv	Urdhri Nr. 599, dt. 07.12.2012 të MASR-së Ristrukturuar me vendimin nr. 575, dt. 01.10.2018 të SENATIT AKADEMIK, UNIKO
13.	Master profesional	MËSUES PËR ARSIMIN E MESËM PROFESIONAL	Aktiv	Vendimi Nr.575, datë 01.10.2018, i Senatit Akademik të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë, “Për një ndryshim në vendimin nr. 162, dt. 21.02.2018 “Për riorganizimin e programeve ekzistuese të ciklit të dytë Master profesional”
14.	Master i Shkencave	KULTURË, MEDIA DHE EDITIM	Aktiv	Urdhër nr. 387, dt. 10.7.2018, MASR
15.	Program Dy-Vjeçar Profesional	EDUKIM PËR FOSH NJËRINË DHE FËMIJËRINË E HERSHME	Aktiv	Miratuar me Vendim Nr. 72, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit (ASCAL)

16.	Program Dy-Vjeçar Profesional	MBËSHTETËS ZYRE PËR KOMUNIKIM, BIBLOTEKË DHE ARKIV	Aktiv	Urdhër nr. 372, dt. 5.7.2018, MASR
------------	-------------------------------------	---	-------	---------------------------------------

Numri i lëndëve për çdo program studimi sipas kategorive (krediteve).

(tabelë lëndët e formimit SHTOJCË)

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	BA/MP/ MSH/PP	NR. I LËNDËVE SIPAS TIPIT TË VEPRIMTARISË				
			A	B	C	D	E
1.	Gjuhë Angleze	BA	36	96	24	18	6
2.	Gjuhë dhe Kulturë Frënge	BA	33	96	27	18	6
3.	Mësuesi për Arsimin Fillor KL.I-VI	BA	6	20	5	5	1
4.	Mësuesi për Arsimin Parashkollor	BA	34	97	22	21	6
5.	Edukim Fizik dhe Sporte	BA	33	96	27	18	6
6.	Histori-Gjeografi	BA	36	90	22	23	9
7.	Gjuhë-letërsi	BA	33	96	24	21	6
8.	Mësues i Gjuhës Angleze	MP	12	48	36	12	12
9.	Mësuesi për Arsimin Fillor	MP	31	95	22	25	7
10.	Mësues në Histori dhe	MP	12	48	36	12	12

	Gjeografi						
11.	Mësues për Gjuhën Shqipe dhe Letërsi	MP	16	42	24	12	24
12.	Kulturë, Media dhe Editim	MSH	12	63	18	12	15
13.	MZKBA	PP	19	62	16	18	5
14.	EFFH	PP	6	23	18	6	7

1. Qëndrueshmëria e programeve të studimit

Programet “Bachelor” në Gjuhë angleze dhe “Edukim Fizik dhe Sporte” janë të qëndrueshme dhe kanë patur prurje të kënaqshme studentësh. Edhe në programet Master Profesional që ofron FEF gjatë vitit akademik 2021-2022 ka patur një qëndrueshmëri përsa i përket numrit të studentëve të regjistruar.

Diplomat e nivelit Bachelor mundësojnë hapin e parë drejt profesionit të mësuesit, por njëkohësisht mundësojnë vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë, në programe që ofron Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, por edhe më gjerë. Këto diploma mundësojnë, gjithashtu, një gamë të gjerë punësimi të studentëve në tregun e punës që kërkojnë aftësi të mira në përkthim, hulumtime gjuhësore, administrim publik, marrëdhënie ndërkombëtare, marrëdhënie publike, media dhe turizëm.

Programet e ciklit të dytë të studimeve i përshtaten misionit të IAL në zhvillimin e perspektivës teorike të studentëve, thellimin e mëtejshëm të tyre në kërkim dhe edukim, në përputhje me kompetencave specifike lëndore dhe ato për jetën. Diploma e ciklit Master Profesional ofron mundësi punësimi si mësues në institucione publike dhe jopublike të arsimit të mesëm të lartë, si specialist pranë drejtorive arsimore, trajnues pranë qendrave të kualifikimit të mësuesve, guidë turistike, ciceronë, si dhe në sektorë të tjerë të veprimtarisë edukative arsimore.

Programi i ciklit të dytë “Master i Shkencave”, ofron studime të thelluara të njohurive teorike, aftësi për kërkim të avancuar dhe të pavarur shkencor si dhe e përgatit studentin me aftësitë dhe kompetencat profesionale për të dalë në tregun e punës,

Programet e studimit 2-vjeçar, me karakter profesional; “Mbështetës Zyre për Komunikim, Bibliotekë dhe Arkiv” dhe “Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”, synojnë të ofrojnë kompetenca profesionale, praktike dhe komunikuese për studentët që mendojnë të punojnë si punonjës mbështetës zyre në institucionet publike dhe jopublike, siç janë bibliotekat për të rritur dhe fëmijë, arkivat në nivele qendrore apo institucione, si dhe në institucionet e edukimit dhe kujdesit, për moshat e vogla.

2. Objektivat që synojnë të arrijnë programet e studimit FEF janë:

Për vitet në vazhdim departamentet duhet të diskutojnë dhe të sjellin rrugë dhe forma të reja të afrimit të një numri më të madh studentësh në punimet e temave të diplomës, në programet Bachelor dhe Master duke i kushtuar më tepër vëmendje temave që përzgjidhen, në mënyrë që shtjellimi ideor i tyre të vijë gjithnjë dhe në rritje dhe të përbëjë një kontribut me vlerë jo vetëm për rritjen e kompetencave kërkimore

dhe profesionale të mësuesit të ardhshëm, por edhe për fakultetin, në zgjerimin dhe pasurimin e fushës kërkimore-shkencore rreth çështjeve dhe këndvështrimeve të reja në fushën e shkencës dhe edukimit.

- formimi i kompetencave shkencore, psiko-pedagogjike, të cilat përputhen me kërkesat e një shoqërie të zhvilluar, për punësim dhe për ruajtjen e vlerave kulturore si dhe të interesave kombëtare;
- nxitja e mendimit kritik përmes një kurrikule me bazë kompetencat e të nxënit;
- përgatitja e mësimeve të suksesshme, me aftësi të thella profesionale dhe cilësi morale, të aftë të përballen me sfidat e një shoqërie në zhvillim;
- formimi shkencor dhe profesional i mësuesve të ardhshëm, të aftë për t'ju përgjigjur në mënyrë konkrete kërkesave të realitetit shqiptar të arsimit parauniversitar, duke përdorur metoda dhe mjete të përshtatshme sipas nevojave të nxënësve dhe për të ndihmuar në edukimin e tyre ndërkulturore.
- departamentet kanë për objekt, në vitet në vazhdim, hapjen e programeve të reja të studimit. Qëllimi është që këto programe të nivelit “Bachelor ose nivelit “Master” të hapen në bashkëpunim me vende të Rajonit dhe të Bashkimit Europian si dhe në kadrin e projekteve të përbashkëta me këto vende
- Programet e reja do synohen të hapen si programe ndërdisiplinore, si një trend i ri për të tërhequr sa më shumë studentë. Hapja e këtyre programeve do të bëhet në saj të bashkëpunimit ndërmjet departamenteve të FEF, bashkëpunimit me departamente të fakulteteve të tjera të Universitetit tonë, por edhe me Universitete brenda vendit dhe me gjerë.

3. Aktivitete kurrikulare të lidhura me ecurinë e programeve të studimit

Në planin mësimor është synuar të ruhet një raport i drejtë midis formimit të përgjithshëm, formimit bazë dhe atij profesional të studentëve për të gjitha nivelet. Planet mësimore të FEF janë hartuar sipas përcaktimeve të Rregullores së Studimeve të Universitetit “Fan S. Noli”. Planet mësimore të secilit cikël organizohen mbështetur në Deklaratën e Bolonjës, ku thelbësor mbetet “Sistemi evropian i transferimit të krediteve”, ECTS (European Transfer System), i cili bën të mundur matjen e të mësuarit dhe arritjet e tij, si dhe ka në qendër ngarkesën e punës që studenti duhet të kryejë për të arritur objektivat e programit të tij të studimit.

Nga Analiza e Veprimtarisë Mësimore përgjatë vitit akademik 2021-2022, rezulton se tipari i përgjithshëm i aktivitetit të FEF në lidhje me qëndrueshmërinë e programeve të studimit ka qenë konsolidimi i kurrikulës dhe programeve mësimore, duke u përqendruar kryesisht te rishikimi i lëndëve apo moduleve që i afrojnë kurrikulat me zhvillimet e tregut të punës, me mundësitë e reja që ofron shkëmbimi i përvojës me universitetet simotra dhe me informacione që përditësohen vazhdimisht nga veprimtaria e kërkimit shkencor që realizojnë. Kështu, u bënë ndryshime të pjessëshme në programin Bachelor “Gjuhë-Letërsi” si; zhvendosje e lëndëve nga një semestër në tjetrin, ndryshime kreditesh sipas kërkesave dhe specifikave të lëndëve etj.

4. Probleme të hasura në lidhje me mbarëvajtjen e programeve të studimit

Disa nga programet e studimit në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë kanë hasur vështirësi për vazhdimësinë e tyre për shkak të ndryshme. Në programet “Bachelor” “Gjuhë-Letërsi”, “Histori-Gjeografi”, “Mësuesi në Arsimin Parashkollor”, “Mësuesi në Arsimin Fillor Kl.I-V ka patur një ulje të studentëve të regjistruar. Në bazë të sondazheve të kryera nga grupet e punës së promovimit të programeve

të studimit theksohet se kjo rënie ka ardhur për disa faktorë si: zgjedhja nga ana e studentëve të programeve të studimit që iu mundësojnë atyre një diplomë e cila u siguron një mundësi punësimi në BE me qëllim largimin, rënie e numrit të maturantëve, zgjatje e viteve të diplomimit në disa nga programet e FEF si dhe orientimi jo i saktë i maturantëve në drejtim të këtyre programeve. Programi Bachelor “Gjuhë dhe Kulturë Frënge” nuk pati studentë të regjistruar për vitin akademik 2020-2021.

5. Drejtimet e punës në të ardhmen në lidhje me programet e studimit

Duke marrë parasysh kërkesat e tregut të punës, disa departamente kanë parë si mundësi çeljen e programeve të reja të studimit. Departamenti i “Gjuhës dhe Letërsisë” punoi për hapjen e programit Bachelor “Media dhe Kulturë Filologjike”, duke hartuar rregulloren e plotë të këtij programi. Programi u rishikua sipas sugjerimeve dhe udhëzimeve të MAS, u riemërua “Studime Kulturore dhe Media” dhe u dërguar në datën 30.11.2021 për miratim.

6. Të dhënat për stafin akademik dhe ndihmës akademik në rang njësie

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, gjatë vitit akademik 2021-2022, ka patur 55 punonjës, nga të cilët 48 punonjës staf akademik me kohë të plotë dhe 6 punonjës ndihmës mësimorë: 1 ndihmës e dekanit, 2 sekretare mësimore, 1 sekretare të zyrës së informimit të studentëve/departamenti, 1 punonjës biblioteke, 1 specialist IT.

Të dhëna për kualifikimin

Staf akademik	Prof.dr. ²⁴	Prof.as.dr.	Dr. ²⁵	Doc.	Asistent pedagog	Total
Pedagogë me kohë të plotë	3	4	33	1	7	48
Pedagogë me kohë të pjesshme	5	3	8	1	21	38

Tabelë SHTOJCË - Të dhëna: Stafi akademik në funksion të programeve të studimit

Programi i studimit	Njësia	Nr. i ped. të brendshëm	Nr. i pedagogëve të jashtëm	Raporti Staf i brend./me kohë të pjesshme	Raporti pedagog BB /student
PP “Mbështetës Zyre për Komunikim, Bibliotekë dhe Arkiv”	Dep. i Gjuhës dhe i Letërsisë	14/7	3	4.6/1	
PP “Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme”	Dep. i Edukimit	10	2	10/2	

²⁴ Titulli akademik Profesor, Universiteti i Tiranës, Shtator 2022, Irena Nikaj Certificate of Excellence in Reviewing Asian Research Journal of Arts & Social Science, 2022

²⁵ Anjeza Vila, Neli Naço

Bachelor në “Gjuhën Angleze”	Dep. i Gjuhëve të Huaja	15 4	3	15/3	15/86
Bachelor në “Gjuhë dhe Kulturë Frënge”	Dep. i Gjuhëve të Huaja	-	-		
Bachelor në “Gjuhë-Letërsi”	Dep. i Gjuhës dhe i Letërsisë	15	5	3/1	
Bachelor në “Histori- Gjeografi”	Dep. i Histori- Gjeografisë	9	2	4/1	
Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”	Dep. i Edukimit	18	2	9/2	
Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor Klasa I-VI”	Dep. i Edukimit	12	8	12/8	
Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”	Dep. i Edukimit	12	8	12/8	
MP “Mësues i Gjuhës Angleze”	Dep. i Gjuhëve të Huaja	13	2	13/2	13/25
MP “Mësues për Gjuhën Shqipe dhe Letërsi”	Dep. i Gjuhës dhe i Letërsisë	16	3	5.3/1	
MP “Mësues në Histori dhe Gjeografi”	Dep. i Histori- Gjeografisë	9	3	3/1	
MP “Mësues për Arsimin Fillor”	Dep. i Edukimit	16	5	16/5	
MSH “Kulturë, Media dhe Editim”	Dep. i Gjuhës dhe i Letërsisë	15	8	1.5/1	

7. Infrastruktura dhe mjediset

Në ndihmë të procesit të mësimdhënies, por edhe të kërkimit shkencor vjen infrastruktura e FEF. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë është organizuar dhe funksionon në kampusin e Universitetit “Fan S. Noli” (Godina e Tretë). E paraqitur në mënyrë strukturore godina përbëhet nga 883 vende për mësim të shpërndara në:

- 1 amfiteatër me 239 vende
- 5 salla auditorësh me kapacitet prej 50-70 vendesh, të gjitha të pajisura me projektor,
- 14 salla seminaresh me kapacitet prej 30-50 vendesh, të cilat janë të pajisura me projektor.
- 1 Qendër Ekselence e pajisur me 2 videoprojektorë, 1 smart board, 7 kompjutera, 1 printer, 1 fotokopje, bibliotekë të specializuar në fushën e didaktikës dhe metodologjisë së mësimdhënies
- 1 mediatekë e Gjuhëve të Huaja, e pajisur me projektor, TV, DVD dhe magnetofon.
- 1 laborator i gjuhëve të huaja me kapacitet 24 vende, i pajisur me projektor dhe sistem të instaluar fonie.
- 1 laborator digjital i gjuhëve të huaja me kapacitet 30 vende, i pajisur me projektor
- 1 zyre sekretarie e pajisur me 2 sete kompjuterike, 1 printer, si edhe 1 fotokopje
- 10 zyra dhe ambiente pune për stafin akademik dhe ndihmës-mësimor.
- 3 mjedise të shërbimit higjieniko-sanitar për studentët dhe 2 për stafin akademik dhe ndihmësmësimor.
- 1 bibliotekë

Shpërndarja e faciliteteve, mjedisve, si dhe kapacitetet e tyre për realizimin e suksesshëm të procesit akademik, paraqiten si më poshtë:

Salla e leksioneve : 5 auditorë, në të cilët zhvillojnë procesin akademik studentë në të gjitha ciklet e studimit,

salla e seminareve: numri i tyre është 9, me një kapacitet prej 40-60 studentësh, Laboratorët (Laboratori i Gjuhëve të Huaja, Laboratori digjital), Biblioteka, SI dhe sekretaria mësimore dhe Zyra e informacionit për student.

Biblioteka “Kongresi i Manastirit” ofron mbi 6 mijë tituj librash të specializuar në shqip dhe në gjuhë të huaja, si dhe Biblioteka e Qendrës së Ekselencës me një fond të specializuar në fushën e didaktikës dhe metodologjisë së mësimdhënies në shqip e gjuhë të huaja. Numri total i titujve shkencorë (libra e monografi shkencore) shqip e në gjuhë të huaj, dokumenteve apo objekteve arkivorë është 6 mijë tituj (mbi 4 000 tituj shqip dhe 2000 tituj në gjuhë të huaj), me një fond rreth 17 000 librash

Biblioteka e Qendrës së Ekselencës me një fond 190 tituj (shqip) 490 tituj (gjuhë të huaj).

Sipas specifikave përkatëse, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë është munduar të arrijë objektiva dhe qëllime në përputhje me procesin e mësimdhënies dhe strategjinë e zhvillimit të Fakultetit:

8. Të dhëna për Qendrën e Formimit të Vazhduar

Qendra e Formimit të Vazhduar - UNIKO është një njësi brenda Universitetit “Fan Noli” Korçë që ka për qëllim organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive trajnuese dhe kualifikuese për mësuesit në shërbim dhe kandidatët për mësues. Drejtimet kryesore të punës së kësaj qendre përqendrohen në zhvillimin e shprehive të mësimdhënies dhe inovacionit në edukim, në mënyrat dhe praktikat e zhvillimit profesional të mësuesve etj. Fushat kryesore që mbulohen nga modulet e ofruara nga Qendra e Formimit të Vazhduar përfshijnë aspekte të kurrikulës në arsimin parauniversitar, metodologjisë së mësimdhënies, të nxënies dhe vlerësimit, etikës dhe komunikimit, gjithëpërfshirjes në arsim, përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie, mentorimit të kandidatëve për mësues, drejtimit të shkollës etj.

Veprimtaria financiare e Qendrës mbështetet në ligjin 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 109, Pika 2, që pasqyrohet në Rregulloren Financiare të Bordit të Administrimit të UNIKO dhe në Vendimin përkatës të Bordit të Administrimit të UNIKO.

Me Vendimin Nr. 135, dt. 20.05.2022 Qendra e Formimit të Vazhduar akreditohet për një periudhë tjetër 4-vjeçare për të realizuar module trajnimi nga Komisioni i Akreditimit të Programeve të Trajnimit. Deri në maj të vitit 2022 Qendra e Formimit të Vazhduar UNIKO ka të regjistruar në databazën e saj mbi 5 000 mësues të trajnuar dhe certifikuar pranë saj.

Vetëm për vitin akademik 2021-2022 janë certifikuar mbi 600 mësues. Me mundësitë që ofron sot teknologjia, gjeografia e mësuesve të trajnuar dhe certifikuar pranë kësaj qendre i ka kaluar kufijtë gjeografikë të qarkut të Korçës, duke trajnuar dhe certifikuar - mësues nga e gjithë Shqipëria. Qendra e Formimit të Vazhduar është pjesë e rrjetit të Qendrave të Formimit të Vazhduar ku bëjnë pjesë të gjitha qendrat e ngritura pranë universiteteve publike në Shqipëri.

Për periudhën 2020-2022, Qendra e Formimit të Vazhduar UNIKO është Koordinator e Rrjetit të Qendrave të Formimit të Vazhduar. Produkti final i këtij projekti ishte dhe “TEAVET International Conference” mbështetur nga Komisioni European në kuadër të Programit Erasmus +, e cila u mbajt në Vlorë. Pjesë e kësaj konference u bënë jo vetëm pedagogë por edhe mësues të trajnuar pranë saj. Botimi i punimeve të kësaj konference u mundësua nga Servicio de Publicaciones, Universidadde León, Spanjë, in cili ishte pjesë e projektit.

Mbështetur në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar 2014-2020 të MASR-së ky projekt kishte si synim një zgjidhje më të mirë për nevojën specifike të ngritjes së kompetencave të mësuesve në shërbim në nivelin e arsimit parauniversitar, duke kërkuar që universitetet shqiptare të kontribuojnë për të ndërtuar një sistem të arsimit dhe aftësimit profesional me cilësi të lartë për mësuesit, duke u shndërruar në siguresit kryesorë të zhvillimit profesional të vazhdueshëm të mësuesve. Projekti u fokusua në zhvillimin e reformës në profesionin e mësuesit në nivelin e arsimit parauniversitar për trajnimin e mësuesve në shërbim të duke hartuar, zbatuar dhe monitoruar një mësim gjithëpërfshirës për të nxënë të gjatë gjithë jetës (LLL).

Projekt bashkëpunimi me Konsullatën e Përgjithshme të Greqisë në Korçë, Zyra e Koordinatorit për Arsimin, Ministria e Edukimit dhe Çështjeve Fetare, Greqi- për trajnimin e arsimtarëve të shkollave shqiptaro-greke. Në këtë kuadër janë realizuar disa seminare trajnuese online dhe me prani fizike në bashkëpunim me zyrën e koordinatorit të arsimit pranë Konsullatës së përgjithshme greke në Korçë me pjesëmarrjen e autoriteteve drejtuese të UNIKO dhe pedagogëve trajnerë të qendrës. Kyprojekt është në vazhdimësi me veprimtari të tjera që do të realizohen në bashkëpunim.

Prej vitit 2021, Qendra e Formimit të Vazhduar UNIKO është pjesë e Projektit EntrAL: Aftësi sipërmarrëse për një arsim modern në Shqipëri, ku Universiteti “Fan S. Noli” është partner në kuadër të Programit Erasmus Plus. Ndër objektivat e këtij projekti synohet edhe shfrytëzimi i qendrave të specializuara të krijuara të trajnimit të mësuesve në përputhje me nevojat e MASR për të rritur mendjen sipërmarrëse në nivel kombëtar përmes trajnimit të akredituar të mësuesve në sipërmarrje, rritjen e mendimit sipërmarrëse në nivel institucional përmes trajnimit të mësuesve dhe kampit të sipërmarrjes, si dhe vendosjen e ekspertizës dhe standardit të ri të trajnimit të mësuesve në sipërmarrjen në universitetet dhe shkollat shqiptare.

Bashkëpunime dhe projekte

(Informacion mbi bashkëpunime ndër-institucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL- ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim)

2.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me Fakultetin Filozofik, Universiteti “Hasan Prishtina” Prishtinë, Kosovë	Memorandum bashkëpunimi Afat kohor 5-vjeçar	18.12.2017	Fusha e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Të rrisin ndërveprimin akademik si promotor i zhvillimit mbarëkombëtar	Organizimi i programeve të përbashkëta, realizimin e botimeve të përbashkëta etj.
3.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me Fakultetin e Filologjisë “Bllazhe Koneski” të Universitetit “Shën Cirili e Metodi” Shkup, Maqedoni	Memorandum për bashkëpunim mësimor dhe shkencor	24.01.2018 Afat kohor 5-vjeçar	Fusha e shkencës dhe arsimit	Shkëmbimin e stafit akademik për biseda, ligjërat dhe cikle leksionesh.	Shkëmbimin e përvojave pedagogjike në përvetësimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies
4.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me: 4.3 Bashkinë Pogradec 4.4 Bashkinë Kolonjë 4.5 Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare,	Marrëveshje për bashkëpunim Bashkinë Korçë, Bashkinë Devoll Afat kohor 3-vjeçar	31/12/021 10.04.2018	Fusha mësimore-shkencore	Planifikim dhe mbështetje periodike në kryerjen e praktikave mësimore për studentët; Certifikimin e studentëve për kontributin e tyre; Organizimin e seminareve, konferencave të ndryshme etj	Aktivitete të ndryshme me interes të përbashkët

	Korçë					
	4.6 TV. Korçë					
5.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale, Korçë.	Marrëveshje për bashkëpunimi	03.04.2019	Fusha mësimore-shkencore	Planifikim dhe mbështetje periodike në kryerjen e praktikave mësimore për studentët e programeve të studimeve Bachelor dhe Master. Organizimin e seminareve, konferencave të ndryshme etj.	Aktivitete të ndryshme me interes të përbashkët
		Afat kohor 2-vjeçar				
		Rinovuar më 04.03.2021 me afat kohor 4-vjeçar	04.03.2021			
	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale, Lezhë	Marrëveshje për bashkëpunimi	21.01.2021			
		Afat kohor 4-vjeçar				
6.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me TV. Sot 7	Marrëveshje për bashkëpunim	11.11.2019	Fusha mësimore-shkencore	Planifikim dhe mbështetje periodike në kryerjen e praktikave mësimore për studentët; Certifikimin e studentëve për kontributin e tyre; Organizimin e seminareve, konferencave të ndryshme etj.	Aktivitete të ndryshme me interes të përbashkët
		Afat kohor 3-vjeçar				
7.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me Aleancën Franceze,	Marrëveshje për bashkëpunim	02.03.2020	Fusha mësimore-shkencore	Planifikim dhe mbështetje periodike në kryerjen e praktikave mësimore për	Aktivitete të ndryshme
		Afat kohor 5-				

	Korçë	vjeçar			studentët; Certifikimin e studentëve për kontributin e tyre; Organizimin e seminareve, konferencave të ndryshme etj.	me interes të përbashkët
8.	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me Educational Centre shpk, Tiranë	Marrëveshje për bashkëpunim Afat kohor 5-vjeçar	05.03.2020	Fusha mësimore-shkencore	Planifikim dhe mbështetje periodike në kryerjen e praktikave mësimore për studentët; Certifikimin e studentëve për kontributin e tyre; Organizimin e seminareve, konferencave të ndryshme etj.	Aktivitete të ndryshme me interes të përbashkët
9	Departamenti i Shkencave të Edukimit “Giovanni Maria Bertin”, Universiteti i Bolonjës me Departamentin e Edukimit	Marrëveshje vetëm për programet: Profesional “EFFH”, Bachelor në “Mësuesi në Arsimin Fillor”	24.04.2019	Fusha mësimore-shkencore	Organizimin e seminareve, konferencave të ndryshme etj.	Aktivitete të ndryshme me interes të përbashkët
10	UNIKO ME BASHKINË KORÇË	Kryesisht për Programin Bachelor “EFS” Afat kohor 5-vjeçar	26.11.2018	Fusha mësimore-shkencore	Planifikim dhe mbështetje periodike në kryerjen e praktikave mësimore për studentët; Certifikimin e studentëve për kontributin e tyre; Organizimin e seminareve,	Aktivitete të ndryshme me interes të përbashkët

					konferencave të ndryshme etj.	
11	UNIKO , Qendra Universitare Nord Baia Mare, Univ. Teknik i Kluzhit	Erasmus+ Key Action 1, Mobility for learners and staff, Interinstitutional Agreement 2018-2021	10.07.2018 Aplikimi për këtë projekt doli fitues në dhjetor 2019 pas aplikimit në janar 2019	Fusha mësimore-shkencore	Pritja dhe asistenca e studentëve dhe të stafit akademik që kryejnë mobilitete	Mundësi për të kaluar deri në një semestër për studentët, trajnim dhe mundësi për të dhënë mësim për stafin akademik
12	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me Qendrën e artit dhe Kulturës, Korçë	Marrëveshje për bashkëpunimi Afat kohor 3-vjeçar	24.09.2021	Fusha mësimore-shkencore	Planifikim dhe mbështetje periodike në kryerjen e praktikave mësimore për studentët; Certifikimin e studentëve për kontributin e tyre; Organizimin e seminareve, konferencave të ndryshme etj.	Aktivitete të ndryshme me interes të përbashkët

13	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura, Korçë	Marrëveshje për bashkëpunimi në funksion të programeve të studimit, Bachelor në “Histori dhe Gjeografi” dhe Master Profesional “Mësuesi në Histori dhe Gjeografi”	14.07.2021	Fusha mësimore-shkencore	Planifikim dhe mbështetje periodike në kryerjen e praktikave mësimore për studentët; Certifikimin e studentëve për kontributin e tyre; Organizimin e seminareve, konferencave të ndryshme etj.	Aktivitete të ndryshme me interes të përbashkët
	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të kulturës Kombëtare Korçë	Marrëveshje për bashkëpunimi në funksion të programeve të studimit “Studime kulturore dhe media”	19/11/2021	Fusha mësimore-shkencore	Planifikim dhe mbështetje periodike në kryerjen e praktikave mësimore për studentët; Certifikimin e studentëve për kontributin e tyre; Organizimin e seminareve, konferencave të ndryshme etj. Programe për zhvillim profesional Intership për studentët	Aktivitete të ndryshme me interes të përbashkët

IV. KËRKIMI SHKENCOR

4.1 Të dhëna për botime monografi

TEKSTE	Tekst mësimor për shkollën e mesme në Republikën e Kosovës	“ <i>Historia 9</i> ”; “ <i>Edukatë Qytetare 9</i> ” (2022)	Alba Kreka
--------	--	---	------------

MONOGRAFI	Histori	<i>Marrëdhëniet Shqipëri – Kinë në vitet 1960 – 1978</i>	Alba Kreka Ne proces
MONOGRAFI	Studime kulturore	“Limelight on the Albanians: British and American Reflections 1921-1939”	Benita Stavre Ne proces
DISPENSA	Gjeografi Dispenca (cikël leksione dhe përmbledhje artikuj)	“Sfidat në edukim në shekullin xxi “ (Liber për ciklin e dytë m-p _)	Dr.L,Kiri, korrik , 2022
STUDIM HISTORIK	Historiku i Univeritetit	Universiteti “Fan S. Noli” Korce	Orjon Ago Metin Venxha Alba Kreka Adelina Nexhipi ISBN: 978-9928-4568-5-4, Promo print, Korçë: 2021

4.2 Të dhëna për aktivitete të karakterit kërkimor me pjesëmarrje nga stafi akademik

NR	EMËRTIMI	TITULLI	STAF	TË DHËNA MBI BOTIMIN
1	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Universiteti “Fan S. Noli” Universiteti i Tiranës Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan: Arritje dhe perspektiva (12.11.2021)	Prof.dr. Dhimitri Bello	“Ne dhe të tjerët –ngjashmëri ,ndryshime dhe paragjykime ISBN: 978-9928-4568-8-5 Fq.200
2	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	<i>-FOREIGN LANGUAGE VIRTUAL MOBILITIES. AN ENHANCEMENT OF HIGHER EDUCATION INTERNATIONALIZATION</i>	Dr.Benita Stavre	“Linguistic perspectives in the lights of social developments” 10.06.2022, Korçë. Ne proces botimi
3	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	“ <i>Interdisciplinary Approaches to Foreign Language Teaching</i> ”,	Dr.Benita Stavre	Book of Abstracts: ISBN: 9789928328724, fq. 4-5. Punimi në proces botimi

4	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	“Dallimet në vargëzim midis 2 përkthimeve të Rubairave nga F.Noli dhe H.Ali Korça”	Prof.as.dr. Jonela Spaho	Çështje të gjuhës, letërsisë dhe përkthimit letrar/ Universiteti “Fehmi Agani”, Gjakovë (17 .06.2022)
5	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Roli dhe kontributi i Kristo Floqit në themelimin e Vatrës	Prof.as.dr. Jonela Spaho	Vatra-“110 vjet në shërbim të Atdheut dhe komunitetit Shqiptar në Amerikë” 14.06.2022
6	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- <i>Folklore as a means of rediscovering forgotten aspects of the traditional life and lifestyle in the Aromanian community of Korce (Albania), Gevgelja and Krushevo (North Macedonia) areas</i>	Phd. Daniela Stoica Nicolae Stanciu	Tradiții uitate (Forgotten Traditions) International Conference, Bucharest, 19.05.2022 Ne proces botimi
7	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- Të rringjallim traditën e mësimit rrëmëneşte në shkollë në zonën e Korçës	Phd. Daniela Stoica	Endangered Languages and Diaspora. Tirana, 16-19 dhjetor 2021
8	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Noi strategji în predarea dialectului aromân copiilor aromâni din zona Corcea, Albania (Strategji të reja në mësimdhënien e dialektit arumun fëmijëve arumunë nga zona e Korçës, Shqipëri)	Phd. Daniela Stoica	International Conference Multi-/plurilingualism, Contrastivity, Comparativism, and Intercultural Communication October 15-16, 2021, Chişinău, Republica Moldova.
9	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Arumunët e Shqipërisë si minoritet etnik: mundësi dhe sfida	Phd. Daniela Stoica	Konferenca shkencore ndërkombëtare: Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan: Arritje dhe perspektiva, Korçë, 12 nëntor 2021

10	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Rreth gegërishtes fishtiane të disa poezive lirike tek “Mrizi i zanave” (interpretime fonetike)	Prof.as.dr. Anyla Saraçi	Atë Gjergj Fishta: Kërkime dhe interpretime” (në kuadrin e 150-vjetorit të lindjes)-Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, -Qendra e Studimeve Albanologjike -Provinca Françeskane Shqiptare (15.12.2021)
11	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Terminologjia, roli për njohjen e gjuhës profesionale në RMV” (shkurt 2022)	Dr.Albina Pajo	“Një vështrim përmbajtësor mbi marrëdhëniet e terminologjisë me gjuhësinë, gjuhësinë e aplikuar dhe me disiplina të ndryshme gjuhësore ISBN: 978-608-4915-13-3
12	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Çështje të standardizimit të toponimisë në RMV Agjencia e Zbatimit të Gjuhës / Shkup	Dr.Albina Pajo	<i>Struktura fjalëformuese e toponimeve në veprën e Mitrush Kutelit”</i> (29-30 .9.2022)
13	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Universiteti “Fan S. Noli” Universiteti i Tiranës Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan:Arritje dhe perspektiva. (12.11.2021)	Dr.Metin Venxha	“Roli i arbëreshëve në formimin e identitetin kombëtar shqiptar
14	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	<i>2nd International Conference: Early Childhood Education and Care: Challanges and Prespectives (Dep Edukimi) 24 tetor 2021</i>	Brixhilda Lilka Rriollza Agolli	Lilka, B. & Agolli, L. Professionals in Early Childhood Services in Albania: The Profile of Speech Language Pathologist (2ndICECECCP):):2nd International Conference: Early Childhood Education and Care: Challanges and Prespectives ABSTRACT E- ISBN978-9928-45-68-6-1. Fq 57-71 © “Fan. S Noli” University. Korca Albania

15	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	“Mbi disa probleme të pakicave etnike ballkanike dhe të drejtat e tyre gjuhësore” (12.11.2021)	ILIA BELLO	Universiteti “Fan S. Noli” Universiteti i Tiranës Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan: Arritje dhe perspektiva Përmbledhje e artikujve UNIKO ISBN: 978-9928-4568-8-5 Fq.158
16	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Fëmijëria e hershme, Mekanizmi i Mirëkuptimit Ndërinstitucional dhe përgatitja e specialistëve që merren me edukimin e këtyre fëmijëve të vegjël.”	ILIA BELLO	International scientific conference “Early childhood education and care: challenges and perspectives” Proceeding book , 15 -10-2021
17	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Education and Culture in Contemporary Society-UNIKO November 2021- AIS Koordinator i konferencës, SPECIAL SESSION ON HIS 150 TH ANNIVERSARY	Prof.dr. Irena Nikaj	Kumtесе “Ndryshimi social dhe ndërlikime të sociopatise si fenomen human” dhe Drejtues sesiioni shkencor kushtuar Gjergj Fishtes-“THE UNIVERSE OF GJERGJ FISHTA” Book of Proceedings
18	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Universiteti “Fan S. Noli” Universiteti i Tiranës Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan: Arritje dhe perspektiva (12.11.2021)	Irena Nikaj	Komente rreth mendimit antik, zhvillimi i shkencës dhe studimeve gjuhësore Përmbledhje e artikujve UNIKO me ISBN: 978-9928-4568-8-5
19	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Tema: Vlerat kulturore dhe historike të emërtimeve të vendeve si trashëgimi kulturore	Irena Nikaj	Çështje të standardizimit të toponimisë në RMV-AZGJ, 29-30.09.2022
20	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Research, Application and Educational Methods" RAEM21, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane	Evionda Pylli	Proceeding në proces 11-12 shtator 2021

21	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Early Childhood Education and Care: Challenges and Perspectives Departamenti i Edukimit, FEF, Universiteti “Fan Noli”	Evionda Pylli	Proceeding Book “ECEC: Challenges and Perspectives”, 2.Dhjetor 2021 ISBN 978-9928- 4568-6-1
22	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Early Childhood Education and Care: Challenges and Perspectives, Departamenti i Edukimit, FEF, Universiteti “Fan Noli”	Donika Dardha Mariela Burda Suela Pici	Dhjetor 2021 Titulli i artikullit: Idetë psiko-pedagogjike të Montesorit. ISBN 978-9928- 4568-6-1
23	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Artificial intelligence in the healthcare industry. Addressing challenges in the implementation process of robotic surgery as a potential alternative to traditional surgery	L.Agolli R.Agolli	The International Conference on Innovation in Business and Technology, Universiteti “Bedër”, Tirane
24	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	The role of teachers in providing care and education for children 0-3 years old based on the principles of the curriculum framework (15 tetor 2021)	R.Agolli A.Kamburi	IST Conference on: Early childhood education and care: challenges and perspectives, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë.
25	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Professionalis in early childhood services in Albania. The profile of speech and language pathologists. (24 tetor 2021)	B.Lilka R.Agolli L.Agolli	IST Conference on: Early childhood education and care: challenges and perspectives, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë.
26	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	2nd International Conference in “Early Childhood education and Care:Challenges and Perspectives” (15 tetor 2021)	A.Kamburi A. Pajo O. Brame Ilirjana Nase	Proceeding Book ISBN: 978-9928-4568-6-1 pp. 32-42

27	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	2nd International Conference in “Early Childhood education and Care:Challenges and Perspectives (15 tetor 2021)	Rriollza Agolli Arjan Kamburi	Proceeding Book ISBN: 978-9928-4568-6-1 pp. 42-49
28	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- <i>Communicating effectively in Eritten English, as an essential need in Higher Education; a class survey in the second year professional study program, Albanian context</i>	Edlira Xega	- Konferenca e 5 ndërkombëtare mbi kërkimin në Shkenca Sociale mbajtur në Paris, Francë., 8-10.04.2022 Ne proces botimi ne Conference Proceedings online me DOI number.
29	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- <i>Enhancing English vocabulary learning through e- learning approaches. A case study ëith 2nd year English students.</i>	Edlira Xega	- Referuese dhe Koordinatore tek Konferenca e pare Nderkombetare, 10- 11.06.2022 , organizuar nga Departamenti i Gjuheve te Huaja, FEF, Universiteti Fan S. Noli, Korce: “ <i>Linguisitc prespectives in the light of social developments; E- learning approaches to linguistic aquisiton</i> ”. Ne proces botimi
30	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- <i>Engaging University Students in Designing an E- magazine</i>	Dorela Kaçauni	13 mars 2022. Konferenca e katërt Akademike mbi mësimdhënien, mësimnxënien dhe edukimin. Berlin. Gjermani
31	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- <i>LearningApps.org as a digital tool to develop the students’ level of English for Specific Purposes</i>	Dorela Kaçauni	28 mars 2022. Konferencë ndërkombëtare. “ <i>Seizing the day</i> ”: <i>Current Research in Global Englishes.</i> Kodolányi János University, Budapest.

32	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- <i>From desks to bureaus-using case studies as part of VCL in Higher Education in Albania.</i> Autor i parë: Eriola Qafzezi Autori dytë: Dorela Kaçauni	Dorela Kaçauni	29-30 prill 2022. Konferenca e nëntë ndërkombëtare: Albanian studies days 2022. “ <i>Crisis and creative destruction</i> ”, <i>Opportunities for modelling the Economy and society.</i> Tiranë.
33	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- <i>A case study on students’ anxiety during online learning</i>	Dorela Kaçauni	10-11.6.2022 Konferenca e parë nderkombetare “Linguistic perspectives in the light of social developments” “E-learning approaches to linguistic acquisition” Korce, Albania. Ne proces botimi
34	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- <i>Re-think teaching and learning, digital tools and në approaches in teaching french as a foreign language</i>	Fabiola Kadi	“Linguistic perspectives in the lights of social developments” 10.06.2022 , Korçë. Ne proces botimi
35	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- <i>Përkthimi letrar, si urë lidhëse mes kulturave, letërsive, botëkuptimeve</i>	Fabiola Kadi	“Çështje të Gjuhës, Letërsisë dhe Përkthimit Letrar” 17.06.2022 , Gjakovë
36	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- <i>Being Creative in Digital Linguistics Classes</i>	Suela Koça	“Linguistic perspectives in the lights of social developments” 10.06.2022 , Korçë. Ne proces botim
37	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- <i>Enhancing Data- Driven Learning and Corpus-based tasks into EFL classroom</i>	Juliana Çyfeku	“Linguistic perspectives in the lights of social developments” 10.06.2022 , Korçë. Ne proces botimi
38	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- <i>Using a concordancer to foster Data-Driven learning and generate tasks from the English ëooden language</i>	Juliana Çyfeku	22-23 Qershor 2021 / 2022 The 2nd International Conference “Mass Communication in the Context of Contemporary Forms of Propaganda on Political Correctness, ëooden Language and Nëëpeak” Technical University of Cluj- Napoca, North University Centre of Baia Mare, Romania & Université du Québec en Abitibi-Témiscamingue,

				Canada. Në proces botimi
39	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	<i>ALBANIAN STUDENTS' PERCEPTIONS OF ONLINE LEARNING</i>	Lindita Kaçani	“Linguistic perspectives in the lights of social developments” 10.06.2022 , Korçë. Ne proces botimi
40	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	<i>-Challenges and difficulties of test compilation 1st year professional master degree students in “Assessment, Testing and Standards of foreign language” module</i>	Lorena Robo	5th International Conference on Research in Social Sciences, 8-10 April 2022 , Paris, Francë, ISBN: 978-609- 485-250-3
41	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	<i>- Enhancing English vocabulary learning through e-learning approaches, a case study ëith 2nd year English students (Co- author</i>	Edlira Xega Lorena Robo	“Linguistic perspectives in the lights of social developments” 10.06.2022 , Korçë . Ne proces botimi
42	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	<i>- Form and/or formality: An insight into retention of evoked meaning(s) through forms of address in English- Albanian translation</i>	Eriola Qafzezi	“Education and Culture in Contemporary Society” “Leadership and Management” 05-06.11.2021 , Korçë
43	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	<i>- From desks to bureaus - using case studies as part of VCL in higher education in Albania (bashkëautore Dr. Dorela Kaçani)</i>	Eriola Qafzezi	Crisis and creative destruction: Opportunity for Remodelling the Economy and Society” DSSH IX, Ditët e Studimeve Shqiptare, 29- 30.04.2022 , UET, Tiranë.
44	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	<i>- Being Virtually (T)Here: Engaging Online Learners to Foster Collaboration in the Virtual Classroom</i>	Eriola Qafzezi	“Linguistic perspectives in the lights of social developments” 10.06.2022 , Korçë. Ne proces botimi

45	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- Përkthimi, gjuha dhe pushteti – një vështrim krahasues në përdorimin e aludimeve në median e shkruar.	Eriola Qafzezi	“Çështje të Gjuhës, Letërsisë dhe Përkthimit Letrar” 17.06.2022 , Gjakovë
46	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- The importance of using microteaching in laboratory classes of teaching study programs (Qershor 2022)	Pavlo Cicko (bashkautor me Prof. Dr. Alma Muharremi)	THE SECOND INTERNATIONAL CONFERENCE “GLOBALISATION AND INTEGRATION IN CONTEMPORARY EDUCATION” U. A. Xhuvani, Elbasan
47	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- Translation and global Englishes: the combination to a better understanding of the real and virtual world	Alma Karasaliu	28 mars 2022. Konferencë ndërkombëtare. “Seizing the day”: Current Research in Global Englishes. Kodolányi János University, Budapest
48	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- Adapting translation activities in post covid classes: a case study ëith the students of master’s degree	Alma Karasaliu	“Linguistic perspectives in the lights of social developments” 10.06.2022 , Korçë. Ne proces botimi
49	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	- The turning point: digital innovation in education and training – foreign language teachers and learners’ perspectives on the access and use of digital technologies	Erinda Papa Daniela Stoica Alda Cicko	“Linguistic perspectives in the lights of social developments” 10.06.2022 , Korçë. Ne proces botimi
50	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	“ A ka një Contradictio in adjecto mes shqipes dhe të folmeve të saj? ”	Ali Jashari	Universiteti “Fan S. Noli” Universiteti i Tiranës 12.11.2021 Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan: Arritje dhe perspektiva Përmbledhje e artikujve UNIKO ISBN: 978-9928-4568-8-5 Fq.54

51	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Faktorët sociolinguistikë dhe kahu i ndërndikimit fonetik...argumente që shërbejnë për të përcaktuar perspektivën e zhvillimit të bilinguizmit shqip-vllahisht në zonën gjeografike të rrethit të Korçës.	Elona Çeçe	Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan: Arritje dhe perspektiva Universiteti “Fan S. Noli” Universiteti i Tiranës 12.11.2021 Përmbledhje e artikujve UNIKO ISBN: 978-9928-4568-8-5
52	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	“ Ndërtim sintaksor të gjuhëve në kontakt: shqip-maqedonisht-arumanisht”	Hysnie Haxhillari	Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan: Arritje dhe perspektiva Universiteti “Fan S. Noli” Universiteti i Tiranës 12.11.2021 Përmbledhje e artikujve UNIKO ISBN: 978-9928-4568-8-5
53	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	“ Gjuha alegorike e Franc Kafkës dhe e Ismail Kadaresë ”	Eris Rusi	Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan: Arritje dhe perspektiva Universiteti “Fan S. Noli” Universiteti i Tiranës 12.11.2021 Përmbledhje e artikujve UNIKO ISBN: 978-9928-4568-8-5, fq 186
54	KONFERENCA NDËRKOMBËT ARE	Jeta dhe vdekja në prozën e Mitrush Kutelit	Eris Rusi	In memoriam- Mitrush Kuteli Muzeu kombëtar i letërsisë rumune , 13-14.09.2021 Në proc
